



# Koha

EDITORIAL

Projektimet  
e fantazuara  
të Mickovskit



Pas referendumit, që u tregua se është një enë e thyer në duart e pushtetit, opozitës maqedonase iu kanë shtuar orekset që të bëjë gatime sipas menysë së saj. Tani Mickovski ka dëshirë të prezantohet si shpëtimtar i vendit, duke shfuqizuar gjithë një sistem drejtësië që ishte ngritur për ta zhbërë piramidën kriminale të ish regjimit

RAJON

Bregedi  
shqiptar, cak  
i blerësve  
të huaj

KULTURË

Lazarati në  
"Hollywood",  
25 mijë fishekë  
për të xhiruar  
filmin "The  
Brave"



## DILEMAT RRETH ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME

# TË GJITHA SHPRESAT TE MICKOVSKI DHE NDËRKOMBËTARËT



Partitë në pushtet po ballafaqohen me qëndrimet e forta të VMRO ndaj votimit të ndryshimeve kushtetuese. Në të gjitha variante që po bisedohet ndër tavolinë, siç mësohet, mund të shpëtojmë nga zgjedhjet e parakohshme vetëm nga një ndërhyrje e ndërkombëtareve tek Hristijan Mickovski për të lënë të lirë deputetë opozitar të jenë të pranishëm në seancë, e kjo më pas të kompensohet me amnisti financiare ndaj ish krerëve të lartë partiak.

## Burgosja e Gruevskit, çka thonë ekspertët?

Shkup, 7 tetor - Ekspertët juridik Zvonko Davidoviq dhe Besa Arifi, lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit për dënimin e ish-kryeminist Nikolla Gruevski, vlerësojnë se asgjë nuk mund ta ndalojë ekzekutimin e dënimit me burg, përveç mjeteve të jashtëzakonshme juridike. Ata thonë se Gruevski mund t'i shfrytëzojë këto mjete vetëm në rast të përbushjes së kushteve të caktuara të parapara me ligj.

Eksperti juridik Davidoviq, thotë se ish-kryeministri Nikolla Gruevski ka të drejtë për ankesë dhe kërkesë për rishqyrtim të vendimit të Gjykatës së Apelit për dënimin me burg. Megjithatë Davidoviq konsideron se kjo ankesë përsëri nuk do ta vonoj ekzekutimin e dënimit.

"Gruevski tani mund të mbrohet me mjete juridike të jashtëzakonshme..."





## EDITORIAL

# PROJEKTIMET E FANTAZUARA TË MICKOVSKIT



Emin AZEMI

**Pas referendumit, që u tregua se është një enë e thyer në duart e pushtetit, opozitës maqedonase iu kanë shtuar orekset që të bëjë gatime sipas menysë së saj. Tani Mickovski ka dëshirë të prezantohet si shpëtimtar i vendit, duke shfuqizuar gjithë një sistem drejtësi që ishte ngritur për ta zhbërë piramidën kriminale të ish regjimit**

Lideri opozitar Mickovski ka dhënë një ofertë tepër bujare. Ai ka kërkuar nga kryeministri Zaevi që menjëherë të heq dorë nga Marrëveshja me Greqinë dhe pastaj të shkohet në zgjedhje. "Populli të vendos", ka thënë ai. Bujaria e opozitarit nuk ndalet me kaq. Ai ka premtuar se partia e tij do të përkrahë formimin e një institucioni prokurorial të ri, "për shkatërrimin e krimit të organizuar dhe korrupsioni menjëherë pas përfundimit të mandati të politizuarës PSP-së". Por, kësaj here, sipas tij, në mënyrë të profesionalizuar dhe e udhëhequr nga Prokuror publik i zgjedhur në bazë të konsensusit të partive dhe i cili do të punojë për rastet e PSP-së, dhe njëkohësisht do të hetojë materialet e incizuara në mënyrë ilegale, për të cilin u tha se për shkak të mandatit të shkurtër nuk janë hetuar. Mickovski ka gjithashtu dëshirë që Prokuroria e re ta testojë edhe periudhën e punës së Qeverisë aktuale dhe të gjitha aferat që lidhen me Qeverinë, përfshirë dhe "parregullsitë e referendumit", por edhe të gjitha materialet e theksuara nga përgjimi ilegal që kanë të bëjnë me Zoran Zaevin dhe LSDM-në.

Derisa lideri shpirtëror i opozitarëve po i bën gati bataniet për të përballur me lehtë dimrin në ndonjë qeli, një lider tjetër, që duket si hija e këtij të parit, po nxjerr nga mëngja kushtëzime, që do t'ia kishin lakmi edhe kontrabandistët më të zëllshëm të uiskit në vitet 20-30 në Amerikë. Vetëm me një dallim se uiski atëbotë përdorej për të shantazhuar sistemin legal fiskal amerikan, kurse ky lideri-hije i opozitës maqedonase synon të shantazhojë gjithçka që lidhet me penalitetet e partisë së tij. Ai kërkon një Prokurori të re dhe paraprakisht çfuqizimin e Marrëveshjes së Prespës.

Pas referendumit, që u tregua se është një enë e thyer në duart e pushtetit me shumë plasaritje, opozitës maqedonase iu kanë shtuar orekset që të bëjë gatime sipas menysë së saj. Tani Mickovski ka dëshirë të prezantohet si shpëtimtar i vendit, duke shfuqizuar gjithë një sistem drejtësi që ishte ngritur për ta zhbërë piramidën kriminale të ish regjimit. Me fjalë të tjera, opozita maqedonase po e fton Zaevin të inkuadrohet në vallen që Gruevski e kishite ndërprerë dhe me këtë të fshihet kujtesa negative me gomën e madhe të kompromiseve të palogjikshme dhe tepër të pamoralshme.

Është goxha e rëndë ajo gomë që do të ndodhet në duart e cilido politikan. Pajtimi politik nuk nënkupton a priori shuarjen e sistemit të pavarur të drejtësisë. Likuidimi i drejtësisë në një vend që ende s'i ka mbyllur të gjitha aferat korruptive dhe kriminale, në fakt është likuidimi i politikave parimore që duhet të vendosen në raport me gjyqësorin. Një opozitë që kërkon Prokurori të re dhe bashkë me këtë edhe çfuqizim të Marrëveshjes së Prespës, nuk është larg fantazive për të projektuar ndonjë realitet ku ajo e sheh veten në krye të proceseve. Mirëpo kjo nuk është e mundur pa zgjedhje, kurse Maqedonia pati zgjedhje parlamentare më pak se para dy viteve dhe aty u vendos kush të shkojë në opozitë dhe kush të vijë në pushtet.

Tani për tani zgjidhja duhet kërkuar brenda Parlamentit.

## LSDM dhe VMRO ua imponojnë luftën primitive për "të fortin e muhallave"

"... në tërë keto shifra janë mbi 200 000 vota të shqiptarëve të cilat LSDM po përpiket t'i përvetesojë si vota koalicioni të bartur nga ajo. Në anën tjetër Vmro trumbeton se të gjithë ata qindra mijëra votues që nuk dolën në referendum janë mbështetës të idesë të cilën e barti ajo. Në tërë këtë lojë shqiptaret nga të dy krahët konsiderohen vetëm ca numra të rëndësishëm për të plotësuar boshllëqet herë të njëjës e herë të palës tjetër por pa kauzë të veten kombëtare. Qëllimi i tërë kësaj që ndodh është që një pjesë e shqiptarëve të urrejnë VMRO pse pengon rrugëtimin drejt NATO dhe BE dhe si inercion i kësaj urrejtje të votojnë LSDM. Në anën tjetër VMRO përpiket që të merr disa vota shqiptare të cilat janë dëshpruar nga qeverisja e LSDM dhe partnerët tjerë numerik të sajë në qeveri, një pjesë tjetër të llojnë se nuk vlen asnjë parti shqiptare e në fakt nuk marrin mundin të bëhen pjesë e partive për t'i përmirësuar të njëjtat e që jam i bindur se vertetë mund të kenë cfar të ofrojnë, si dhe një pjesë që sistemi ua ka vlarë shpresën dhe ambiciet deri në atë pikë sa arritje më të madhe konsiderojnë kur arrijnë të jenë në kategorinë e nivelit të parë sipas Piramidës së Masllovit e që është mbijetesa. Nga kjo panoramë duket që ata, LSDM dhe VMRO po luftojnë dhe kordinohen për të bërë shtet me dominim total të maqedonasve ndërsa shqiptarëve të copëtuar në kaq shumë pjesëza ju imponojnë luftë primitive për "të fortin e muhallave" që në fund shqiptaret të duken vetëm tifozë herë të njëjës palë maqedone herë të palës tjetër deri në zhdukjen përfundimtare të çështjes shqiptare dhe të partive shqiptare si organizim që kanë për obligim të bartin çështjen shqiptare në këtë vend", një pjesë nga statusi në Facebook i Remzi Memedit.

## Ne problemet i kemi brenda vetes

Nëse është kusht për të hyrë në BE me korigjimin e kufijve, atëherë kurrë mos të hyjë Kosova në BE. Nëse ka humbur territor kjo është Kosova dhe shqiptarët në Ballkan, çka nuk ka ndodhur me asnjë vend tjetër në botë. Kështu që në këtë aspekt ne nuk duhet të luajmë me çështjet e territorit dhe të kufijve. Kosova ka probleme të tjera, me institucionet qeverisëse, me shtetin ligjor, me papunësinë, me partitokracinë dhe sidomos me ekonominë. Nëse ne do të kishim ngritur ekonomine dhe do të kishim pasur dinjitet kombëtar dhe do të kishim një klasë politike jo të korruptuar, nuk do të ishim atje ku jemi sot, por shumë më përpara. Por ne në Kosovë, Shqipëria dhe një pjesë e shqiptarëve të Maqedonisë, për fat të keq, kemi klasën politike më të korruptuar në botë. Sikur mos të ishin të korruptuar, ne nuk kishim nevojë të hynim BE fare, sepse një bashkim i tregut midis Kosovës dhe Shqipërisë do të krijonte tjetër realitet. Nga ana ekonomike ne me Shqipërinë kemi dhjetëfishin e burimeve që ka Gjermania. Pra kjo nuk do të thotë që ne nuk kemi pasuri, por nuk kemi administratore politikë që këtë pasuri ta menaxhojnë për të mirën e popullit të vet, por kemi administratore politikë që këtë pasuri e kanë çuar në koncesion e në drejtim të paditur dhe ne shohim përditë edhe sot se edhe taksat për qytetarët vijnë nga papërgjegjshmëria e lartë politike. Ne nuk i kemi probleme vetëm me "fqinjët", ne problemet i kemi brenda vetes në radhë të parë, sepse nuk kemi klasë politike të dinjitetshme, që të di t'ia bëjë '8 me 2' fqinjëve dhe të dijë të mbrojë interesin kombëtar. Shqip e shkurt klasa politike e jona nuk di të mbrojë interesin kombëtar e as popullin e vet, e çka po doni më tepër me ditë se jemi popull i idhët", ka shkruar në status në Facebook, aktivistja nga Prishtina Hafize Elshani

## MEDIA Citate

### Stoltenberg në Beograd: Ju bombarduam për të mirën tuaj



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka deklaruar se shumë njerëz në Serbi ende kanë kujtime të këqija nga bombardimet e vitit 1999, por tha se kjo është bërë në mënyrë që të mbrohen civilët dhe të ndalohej qeverisja e presidentit të atëhershëm të Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq. "Kam thënë se e kemi bërë këtë që të mbrojmë civilët dhe ndaluar regjimin e Millosheviqit. Por, porosia ime më e rëndësishme është që duhet të shohim kah e ardhmja", ka thënë Stoltenberg për televizionin publik serb.

Ai shtoi se NATO-ja mbështet dialogun Kosovë-Serbi dhe jo vetëm politikisht.

"NATO-ja e mbështetë dialogun, jo vetëm politikisht, por edhe me faktin se jemi prezentë në Kosovë me KFOR-in, mandati i të cilit është ruajtja e sigurisë. Edhe më tutje do të jemi aty që të mbrojmë të gjitha nacionalitetet", tha Stoltenberg.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, do të qëndrojë të hënë në një vizitë zyrtare në Republikën e Kroacisë.

Kjo është bërë e njohur nga zyra për informim dhe marrëdhënie me jashtë e NATO-s. Në Kroaci Stoltenberg pritet të takohet presidenten e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović, me kryeministrin Andrej Plenković dhe zëvendëskryeministrin dhe ministrin e mbrojtjes atje, Damir Krstićević.

(Televizioni publik i Serbisë, 7 tetor)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

### CILA ËSHTË LUFTAMË E SHKURTËR NË HISTORI?

Lufta pak e njohur Anglo-Zanzibar e vitit 1896 konsiderohet përgjithësisht si lufta më e shkurtër në histori, që zgjati në total vetëm 38 minuta. Historia fillon me nënshkrimin e traktatit Heligoland-Zanzibar midis Britanisë dhe Gjermanisë në 1890. Ky traktat në mënyrë efektive krijoi sfera të ndikimit midis fuqive perandorake në Afrikën Lindore; Zanzibar i dorëzohet influencës britanike, ndërsa Gjermanisë iu dha kontrolli mbi territorin e Tanzanisë.

Me këtë ndikim të ri të gjetur, Britania e shpalli Zanzibarin nën protektoratin e Perandorisë Britanike dhe u zhvendos për të instaluar Sultinin e vet "kukull" për t'u kujdesur për rajonin. Hamad bin Thuwaini, i cili kishte qenë mbështetës i britanikëve në zonë, dhe iu dha pozita e udhëheqësit në vitin 1893.



8.27.1896



Partitë në pushtet po ballafaqohen me qëndrimet e forta të VMRO ndaj votimit të ndryshimeve kushtetuese. Në të gjitha variante që po bisedohet ndër tavolinë, siç mësohet, mund të shpëtojmë nga zgjedhjet e parakohshme vetëm nga një ndërhyrje e ndërkombëtareve tek Hristijan Mickovski për të lënë të lirë deputetë opozitar të jenë të pranishëm në seancë, e kjo më pas të kompensohet me amnisti financiare ndaj ish krerëve të lartë partiak.

DILEMAT RRETH ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME

# TË GJITHA SHPRESAT TË MICKOVSKI DHE NDËRKOMBËTARËT



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 7 tetor - Dy partitë kryesore në pushtet LSDM dhe BDI po vazhdojnë bisedimet me deputetë të opozitës për të marrë përkrahjen e tyre lidhur me votimin ndryshimeve kushtetuese që kanë të bëjnë me zbatimin e Marrëveshjes për emrin. Bisedimet që po mbahen të mbyllura për opinionin, do të dihet nëse kanë rezultuar me sukses apo jo deri në fund të javës së ardhshme. Votimi i ndryshimeve kushtetuese është jetike për kryeministrin Zoran Zaev andaj siç mëson gazeta KOHA në rrugë jozyrtare, nëse rast se nuk mund të garantohen votat e nevojshme deri në fund, Zaev do të kërkojë ndihmën e ndërkombëtarëve për zgjidhjen e ngërçit politik. Kjo pasi shkuarja në zgjedhje nuk po shihet si opSION i mirë dhe që mund të dalin mirë deri në 81 vota edhe në rast se shkojnë me lista të përbashkëta. Në këtë pikë nëse veprohet në mënyrë të një anshme,

pra të shpërndahet Parlament pa mos i plotësuar kërkesën VMRO-së për qeveri teknike, është më se mundur që VMRO të bojkotojë zgjedhjet. Por se kjo vërshtirë se do të pranohet nga ndërkombëtarët. Andaj po shpresohet një ndërhyrje e një dorë të fortë nga diplomacisë ndërkombëtare të gjej zgjidhje me VMRO në moment të fundit pasi që investimi i ndërkombëtarëve në aritjen e Marrëveshjes për emrin me Greqinë nuk ka asnjë shanzë që të shkojë huq. Nëse ndodh kjo nuk është i pamundur edhe amnestia eventuale për ish krerët e VMRO-së nga burgimi. Ndryshe Amnistia për krime financiare nuk është se nuk ka ndodhur në shtetet tjera, dhe tani kur Maqedonia është para një sfide të madhe historike ka gjasa të ndodh por se do të rregullohet në atë mënyrë që LSDM të mos etiketohet se toleroi amnistinë por kjo do ti lihet organeve të gjyqësore. Se

VMRO po tenton të merr amnisti për krime financiare kjo u pa në mënyrë indirekte edhe të dielën kur lideri i VMRO-së Hristijan Mickovski duke folur për kushtet e tij për qeveri teknike përmendi atë që prokuroria speciale të hetojë siç tha ia krimet qeverisë Zaev, përfshirë dhe parregullsitë gjatë referendumit.

"Zgjidhja e arritur është katastrofike. Tani mund të konkludojmë vetëm se Marrëveshja ka vdekur. Një marrëveshje pa konsensus që premtion të përmbushë diçka që nuk mund të përmbushet, duke manipuluar komunitetin ndërkombëtar që kjo marrëveshje mund të kalojë. Përkundër presioneve, shantazheve, mbushjen e kutive, qeveria dështoi të manipulonte qytetarët që treguan përgjegjësi për vendin e tyre. Në këtë moment ajo është krejtësisht delegjitimuar, Zaev nuk ka legjitimitet dhe besueshmëri, rezultati në referendum dha përgjigje që kri-

minelët nuk duhet të vazhdojnë. Njerëzit dërguan një mesazh se Zaev nuk mund të jetë më kryeministër dhe duhet të tërhiqet. Një krizë e re do të ulë ekonominë edhe ashtu të brishtë, ndërsa me këta njerëz do të jetë vetëm më keq. Prandaj ka dy opsione: Zgjedhjet, të cilat duhet të jenë sipas Marrëveshjes së Përzhinos siç ishte qeveria para zgjedhjeve në vitin 2016 dhe prokurori publik të ri të propozuar nga opozita, dhe komisioni i hetimit", ka theksuar Hristijan Mickovski. Pas asaj, siç tha Mickovski VMRO-DPMNE-ja do të përkrahë formimin e një institucioni prokurorial të ri, për shkatërrimin e krimet të organizuar dhe korrupsioni menjëherë pas përfundimit të mandati të politizuarës por kësaj here në mënyrë të profesionalizuar dhe e udhëhequr nga prokuror publik i zgjedhur në bazë të konsensusit të partive dhe i cili do të punojë për rastet e PSP-së, dhe njëkohësisht

do të hetojë materialet e incizuara në mënyrë ilegale, për të cilin u tha se për shkak të mandatit të shkurtër nuk janë hetuar.

"Prokuroria e re do ta testojë edhe periudhën e punës së Qeverisë aktuale dhe të gjitha aferat që lidhen e Qeverinë, përfshirë dhe parregullsitë e referendumit, por edhe të gjitha materialet e theksuara nga përgjimi ilegal që kanë të bëjnë me Zoran Zaevin dhe LSDM-në", ka thënë Mickovski. Ai refuzoi të japë përgjigje të saktë në lidhje me pyetjen se a janë të sakta spekulimet se Qeveria e Maqedonisë është duke iu ofruar diçka deputetëve opozitarë, në këmbim të amnistisë së ish liderit dhe ish kryeministrit të Maqedonisë, Nikolla Gruevski. Ky i fundit, iu është drejtuar deputetëve të VMRO-DPMNE-së në ora 3 të mëngjesit, i ka paralajmëruar që të mos bien në gjuhë dhe mos të pranojnë asnjë kusht për të ndërprerë përndjekjen politike ndaj tij. "Nëse nga ju, kush do qoftë dhe në çfarë do lloj forme kërkon të bëjë edhe hapin më të vogël që do të ishte në dëm të shtetit dhe interesave shtetërore, duke e vendosur këtë në korrelacion me ndërprerjen e rendit politik kundër meje, si udhëheqës shumëvjeçar i Organizatës së Brendshme Revolucionare të Maqedonas dhe si ish-kryetar i partisë së VMRO-së, dhe deputet aktual, Ju lus të mendoni, pas asnjë hezitimi, ta hidhni propozimin e tillë të pahijshëm", shkroi Gruevski në Facebook duke iu drejtuar partisë së tij.

SHËTITJE NË SHKUP

## ECJE PËR NGRITJEN E VETËDIJES KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT

Ambasadori amerikan, Xhes Bejli tha se me ecjen e sotme, personat në Shkup bëhen përkrahës të qindra dhe mijërave njerëzve nga bota në shëtitje kundër kancerit të gjirit, për ngritjen e vetëdijes dhe mjetet e nevojshme për parandalim, hetim dhe përkrahje të grave



ten e vetëdijes në luftë kundër kancerit të gjirit në Maqedoni.

Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, para fillimit të manifestimit në Parkun e Qytetit në Shkup, porositi se detektimi i hershëm dhe skriningu mund të çojnë deri në shërimin e plotë të kësaj sëmundjeje malinje nga e cila vuajnë shumë gra.

"Në Ministrinë e Shëndetësisë jemi të përkushtuar plotësisht në zbatimin e parandalimit të programit, në përmirësimin e sistemit për caktim të incizimit për këto pacientë dhe me përkushtim punojmë në formimin e komisionit për listë pozitive të barnave", tha Filipçe. Në lidhje me vërejtjet e pacientëve për "Termini im", ministri

Filipçe tha se kanë pasur mbledhje të punës dhe kanë dhënë vërejtje, që tashmë janë implementuar në masa konkrete me të cilin është rritur numri i terminëve në klinika dhe në Klinikën e Radiologjisë, ku koha e pritjes do të ulet dhe pacientët me sëmundje malinje do të kenë formë të veçantë në prioritet të caktimit të incizimeve.

"Disa ditë në ndërprerje ishte puna e tomografisë kompjuterike, për shkak instalimit të aparatit të ri, që është kapacitet më i mirë dhe më i madh i të vjetrit. Ku edhe të vjetrin do ta vendosim në vend të ri, me të cilin do të dublohet kapaciteti", tha Filipçe.

Ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska theksoi se është e rëndësishme që të gjithë gratë ta zbulojnë metodë sëmundjen dhe ta parandalojnë këtë

sëmundje dh t'i japim përkrahje njëri-tjetrit.

"Të gjitha gratë që për momentin nuk kanë bërë kontrollë, sot duhet të rikujtojnë se duhet të bëjnë dhe ta parandalojnë atë që më tej duhet të shërohet. Vetëm me rritjen e vetëdijes publike mund ta parandalojmë disa viktimat nga kjo sëmundje", tha Carovska.

Ambasadori amerikan, Xhes Bejli tha se me ecjen e sotme, personat në Shkup bëhen përkrahës të qindra dhe mijërave njerëzve nga bota në shëtitje kundër kancerit të gjirit, për ngritjen e vetëdijes dhe mjetet e nevojshme për parandalim, hetim dhe përkrahje të grave.

"Të gjithë ne mund të ndihmojmë në ngritjen e vetëdijes dhe parandalimit", tha Bejli.

Shkup, 7 tetor - Pacientë me kancer në gj, të shëndosur nga kjo sëmundje dhe qytetarët përkrahës sot për të dhjetën herë me radhë morën pjesë në shëtitjen për ngritjen



# LLOGARITJA E KOHËS, MAQEDONIA DO TË KOORDINOHEK ME EUROPËN

Shkup, 7 tetor - Gjatë uikendit më 28 dhe 29 të këtij muaji në Maqedoni do të fillojë llogaritja dimërore e kohës. Akrepat e orët do të zhvendosen, ndërsa në pajtueshmëri të vendimit të marrë në Evropë që të pezullohet ndryshimi i kohës, në Maqedoni ndiqet procesi i miratimit të propozim-direktivës dhe pason harmonizim i legjislacionit kombëtar të RM-së dhe përcaktim të mënyrës së transpozimit të direktivës së BE-së.

Propozimi i Byrosë për metrologji, siç na informojnë nga Ministria e Ekonomisë, do të dorëzohet deri te Qeveria për vendimarrje.



“Në propozim-direktivën e re për ndërprerje të ndryshimeve sezonale të kohës e cila ende nuk është publikuar në Gazetën zyrtare të KE-së dhe Parlamentin e BE-së është theksuar se vendet-anëtare duhet ta transpozojnë deri më 1 prill të vitit 2019 dhe të pro-

noncohen për zgjedhje të kohës standarde e cila do të zbatohet në nivel lokal. Byroja për metrologji i ndjek ndodhitë lidhur me procesin e miratimit të direktivës për ndërprerje të ndryshimeve sezonale të kohës. Pas miratimit të propozim-direktivës, pason harmonizim i legjislacionit kombëtar të Republikës së Maqedonisë dhe përcaktim të mënyrës së transpozimit të direktivës së lartpërmendur, ndërsa propozimi nga Byroja për metrologji do të dorëzohet deri te Qeveria e RM-së për vendosje”, njoftojnë nga Byroja për metrologji.



## Gruevski ia ban gajlen partisë, e ka harruar veten!

Shkup, 7 tetor - Ish-lideri i VMRO-DPMNE-së, Nikola Gruevski në profilin e tij në Facebook dërgoi paralajmërim deri te partia e tij se nuk guxon të shantazhohet, sepse siç shkruan, nëse VMRO-DPMNE është e shantazhuar edhe Maqedonia.

Ai shkroi se do të luftojë sa të mundet kundër kësaj “përndjekje politike” dhe me çmim të dinjitetit të tij, lirisë se jetës. Gruevski thotë fëmijët e tij kur do të rriten dhe kur do të mësojnë për luftën dhe idealet e tij, do të kuptojnë drejtë gjithçka.

## KOM është kundër emrit të saj

Shkup, 7 tetor - Kisha ortodokse maqedonase – dioqeza e Ohrit në seancën e rregullt vjetore të Këshillit popullor të kryepeshkopëve vërtetoi qëndrimin për mos ndryshimin e emrit të KOQ dhe emrit të shtetit.

“Kisha Ortodokse Maqedonase trashëguese historike dhe ligjore e Kryepeshkopatës së Ohrit në Justiniana e ruan dinjitetin e kryepeshkopatës dhe mban emrin Kisha Ortodokse Maqedonase – Kryepeshkopata e Ohrit, në komu-

nikim me Kishën Ortodokse maqedonase”, deklaroi kryepeshkopi Timotej.

Ai shtoi se anëtarët e Këshillit popullor të kryepeshkopëve njëzëri të dërgojnë apel për bashkim kombëtar.

“Ju bëjmë thirrje dhe lutje të sinqertë të gjithë subjekteve politike në vend për qasje të përgjegjshme në këtë periudhë shumë të ndërlikuar dhe përplot me sfida për atdheun tonë me propozim që të shfrytëzojnë të gjithë forcat për ruajtjen e iden-



tetit kombëtar dhe shpirtëror të popullit maqedonas dhe gjithçkaje që është maqedonase”, u shpreh Timotej.



## Xhaferi: Nuk ka iniciativë për shpërbërjen e Kuvendit

Në Kuvend nuk ka asnjë iniciativë zyrtare për shpërbërjen e ligjvënësit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi në një intervistë për Alsat shprehet optimist se deputetët opozitarë do të reflektojnë pozitivisht ndaj ndryshimeve kushtetuese dhe se çështja do të mbyllet në ligjvënës pa pasur nevojë për zgjedhje të reja.

Duke folur për afatet të cilat lidhen ngushtë me ndryshimet Kushtetuese dhe ratifikimin e marrëveshjes në Kuvend, Xhaferi saktëson se koha nuk premtan për të nisur ndryshimet pas zgjedhjeve të mundshme.


## Cilët deputetë të VMRO-së negociojnë për të përkrahur Zaevin

Shkup, 7 tetor - Gjashtë deputetë të VMRO-DPMNE-së janë në bisedime për të përkrahur ndryshimet kushtetuese, ka raportuar Telma. Sipas burimeve të këtij mediumi, nënkryetari i LSDM-së Zekiri ka pohuar se po negociohet me të gjithë deputetët e kësaj partie, përveç me Nikola Gruevskin.

Afatet kohore janë të shkurtra dhe Zaev duhet të vendosë brenda 7-8 ditësh nëse do të shkohet në zgjedhje të parakohshme parlamentare.



## Avokati i Popullit bëhet pishman rreth filmit “Tallja me Krishtin”



Shkup, 7 tetor - Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë ne-

së do ta tërheq propozimin deri te Gjykata Themelore Shkupi 2 për

shqiptimin e masës e ndalimit të filmit “Tallja me Krishtin” ku UÇK-

ja shfaqet si organizatë terroriste. Siç kumtojnë nga Avokati i Popullit, vendimi është sjell pas shqyrtimeve të plota dhe analizave juridike.

“Nga ana e Avokatit të Popullit, pas informacionit se filmi tashmë emitohe, është konstatuar se në raport me kërkesën tashmë nuk ka bazë juridike. Në pajtim me ingerencat, veprimi i Avokatit të Popullit do të jetë i drejtuar vetëm në mbrojtjen e të drejtave pronësore të Republikës së Maqedonisë lidhur me pagesat për kompenzimin e filmit nga buxheti i Republikës së Maqedonisë”, thonë nga zyra e Avokatit të Popullit.



QËNDRIMET E DIPLOMATËVE TË HUAJ PAS DËSHTIMIT TË REFERENDUMIT

# ZGJEDHJET E REJA DO TË JENË STËRZGJATJE E PROCESIT

Dalja e ulët në referendum është reflektim i lodhjes gjithnjë e më të madhe prej politikës në Maqedoni. Shumë qytetarë janë thjeshtë të lodhur prej të gjitha kontesteve në politikë, deklaroi përfaqësuesi i fondacionit "Konrad Adenauer" në Maqedoni, Johanes Rai

Shkup, 7 tetor - Kanë kaluar pothuajse një janë nga zbatimi i referendumit në vend, Hyrja në NATO dhe BE e Maqedonisë është prioritet, nga i cili nuk heqin dorë as pushteti, as shumë organizata ndërkombëtare. Maqedonisë, siç theksohet nuk i nevojiten zgjedhje të parakohshme, por zbatim i Marrëveshjes me Greqinë me sigurimin e dy të tretës së shumicës në Kuvend.

Eurokomisari për politikë të fqinjësisë dhe zgjerim Johanes Han konsideron se nuk nevojiten zgjedhje të parakohshme parlamentare në Maqedoni, por duhet të shfrytëzohet mundësia të sigurohen dy të tretat e shumicës në Kuvend për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës. Në deklaratën për gazetën austriake "Kurier", Han ka thënë se këtë porosi veç më ia ka përcjellë kryeministrit të Maqedonisë, Zoran Zaev.

"Zgjedhjet e reja do të jenë stërzgjatje e rrugës drejt fillimit të negociatave për qasjen e IRJM-së në BE, e planifikuar në verë vitin e ardhshëm", ka thënë Han. Sipas tij nuk mund të thuhet se ka qenë i patsuksesshëm.

"E pazakontë është në referendum të merret mbështetje prej 94 për qind, por të dalin vetëm 36.8 për qind e votuesve, edhe atë pasi opozita padyshim ishte e suksesshme në bojkotimin", ka thënë eurokomisari dhe shton se në Kuvend mund të sigurohet dy të tretat e shumicës.

"Nevojiten tetë apo nëntë vota nga opozita dhe ajo patjetër të jetë e realizuar. Të gjithë thonë se duan anëtarësim në BE dhe NATO duke përfshirë edhe opozitën, dhe

atëherë patjetër të paguani çmimin e kësaj zgjidhje. Bëhet fjalë për zgjidhje që është në interes të vendit, jo të partive apo politikanëve. Dhe në atë rast si mund të sigurohen votat? Unë besoj më kombinimin mes racionale dhe asaj balkanase", ka thënë komisari për zgjerim Johanes Han. Maqedonia për momentin gjendet në një periudhë shumë vendimtare pas referendumit të javës së kaluar. Duhet të sillt vendim për ardhmërinë e vendit dhe atë afatgjatë. Ka ardhur koha kur opozita dhe Qeveria duhet të mundohen të gjejnë një zgjidhje të përbashkët, porosi në Shkup deputeti i Bundestagut gjerman Torsten Fraj.

"Unë thjeshtë e kuptoj atë që njerëzit në Maqedoni e kanë të vështirë sa i përket Marrëveshjes me Greqinë. Ju kuptoj mirë sepse bëhet fjalë kryesisht për identitetin kombëtar. Megjithatë, konsideroj se është e rëndësishme që të shqyrtohen alternativat dhe mundësitë. A është e mundshme të arrihet Marrëveshje më e mirë, a mund të shkohet në rrugën e integritimit në BE dhe në NATO pa këtë Marrëveshje. Nëse jemi të sigurt, më duket se duhet të themi se mundësi të tillë nuk do të ketë nëse nuk arrihet Marrëveshja. Ai është vendim i popullit të Maqedonisë dhe vendim të cilin duhet ta sjellë Kuvendi i Maqedonisë", theksoi Fraj në forumin e dytë midis Maqedonisë dhe Gjermanisë "Ndërtojmë ura – politika dhe ekonomi", i cili u mbajt sot.

Sipas tij, në këtë moment duhet të sillt vendim për ardhmërinë e

vendit dhe se ka ardhur koha kur opozita dhe Qeveria duhet të përpiqen të gjejnë një zgjidhje të përbashkët politike.

"Nuk bëhet fjalë për atë se deputetët individualë të manipulojnë, por bëhet fjalë për të arritur më të mirën për shtetin. Nga pikëpamja ime konsideroj se Qeveria dhe opozita duhet së bashku të gjejnë zgjidhje të mirë për të mirën e vendit", ju porositi Fraj politikanëve të Maqedonisë në Shkup.

Dalja e ulët në referendum është reflektim i lodhjes gjithnjë e më të madhe prej politikës në Maqedoni. Shumë qytetarë janë thjeshtë të lodhur prej të gjitha kontesteve në politikë, deklaroi përfaqësuesi i fondacionit "Konrad Adenauer" në Maqedoni, Johanes Rai në Forumin e Maqedonisë dhe të Gjermanisë në Shkup "Ndërtojmë ura – politika dhe ekonomi".

"Për 3,5 vjet jam në Maqedoni dhe kam pasur mundësi të njoftoj shumë persona. Përshtypja ime është se gjithnjë e më shumë qytetarë nuk kanë dëshirë t'i dëgjojnë lojërat e politikanëve dhe të kërkojnë atë që kërkohet prej tyre "ose je me ne ose je kundër nesh", thotë Rai.

Ai vlerëson se se shumë prej qytetarëve të Maqedonisë vendosën ta braktisin shtetin.

"Treqind mijë qytetarë të Maqedonisë jetojnë jashtë vendit, megjithatë ka edhe numra të tjerë se ata janë ndoshta 400 mijë apo gjysmë milionë. Askush më saktë nuk e di numrin e qytetarëve të zhvendosur nga Maqedonia", theksoi Rai.



Ka ardhur koha, thotë ai, të ndalojë ky largim i inteligjencës, ndërsa për këtë është nevojshme të ekzistojë sistem politik dhe institucione të cilat funksionojnë.

"Mendimi im është se tani pas referendumit nuk janë të nevojshme zgjedhje të reja. Ajo që është e nevojshme është regjistrimi dhe Listë zgjedhore e korigjuar. Më falni që do ta them edhe këtë, por është habi që edhe kryetari i Kuvendit nuk mund të gjendet në Listën zgjedhore dhe nuk mund të votojë në referendum", thotë Rai.

Ambasadori gjerman në Maqedoni, Tomas Gerberih, nga ana tjetër, bëri thirrje opozita të mos e bllokojë procesin dhe të gjendet zgjidhje në Kuvend. Tha se personalisht shpreson se opozita do të kyçet në proces dhe nuk do ta largojë vendin nga Bashkimi Evropian dhe NATO.

Ambasadori Gerberih shpreh keqardhje që dalja në referendum ka qenë vetëm 36 për qind por, siç theksoi, prononcimi për referendumin ka qenë konsultativ dhe jo i obligueshëm dhe prandaj procesi duhet të vazhdojë në institucione. Marrëveshja e Prespës kuptohet

se është gjallë. Të dyja palët, edhe IRJM edhe Greqia, janë të vendosur që të luftojnë që marrëveshja të hyjë në fuqi, thotë zëdhënësi i Qeverisë greke dhe ministri pa dikastrer, Dhimitris Xanakopulos në intervistën për radion greke "Njuz247".

Xanakopulos e ka përsëritur qëndrimin e MPJ-së greke se rezultati nga referendumi është

kontradiktore, por shtoi se "nëse nuk gabon, referendumi kishte jehonë të madhe nga përshembull jehona në zgjedhjet presidenciale".

"Mendoj se është në drejtim absolut të drejtë nisma e zotit Zaev, diskutimin ta dërgojë në Kuvend dhe të përpiket ta formojë shumicën e nevojshme për revizionin kushtetues. Ne i përcjellim ngushtë ngjarjet, e mbështesim përpjekjen që ta ndryshojë Kushtetutën që të mundet edhe Qeveria greke ta ratifikojë marrëveshjen që të hyjë në fuqi", tha zëdhënësi i Qeverisë greke.

Lidhur me pozicionet e partitit qeveritar koalicionues, Panos Kamenos, Xanakopulos sqaroi se nuk ekziston shkas për shqetësim për të ardhmen e Qeverisë.

VLERËSIMET TË JANUSH BUGAJSKIT PËR MAQEDONINË

## ZGJEDHJET E PARAKOSHME-PROPOZIM I RREZIKSHËM

Presidenti serb Aleksandar Vuçiq dhe presidenti kosovar Hashim Thaçi kanë arritur marrëveshje për ndryshim të kufijve

Analisti amerikan Janush Bugajski vlerësoi se Shkupi është

strehimore e re ruse në Ballkan dhe se Kremli konsideron në këtë se Maqedonia mund të bëhet Republika Serbe e re.


"Nëse bllokohet rruga e Maqedonisë drejt institucioneve perëndimore, tensionet kombëtare do të rriten në gjithë rajonin, ndërsa Kremli do të investojë energji plotësuese që t'i rrezikojë arritjet e brishta demokratike në Ballkanin Perëndimor, ndërsa BE-ja dhe NATO do të jenë gjithnjë e më

larg", thotë Bugajski në deklaratë për "Pobjeda".

Ai shton se jehona e ulët në referendum e ka sjellë në pikëpyetje marrëveshjen me Greqinë, por edhe derën e hapur nga NATO dhe BE-ja. "Në qoftë se Marrëveshja nuk është mbështetur, vendi më shumë i ekspozohet radikalizimit etnik, jo-stabilitetit rajonal dhe përzierjes së Moskës. Rrugëdalja e vetme e Zaevit mund të jetë thirrje për zgjedhje të parakohshme në

nëntor, edhe pse kjo vetvetiu paraqet propozim të rrezikshëm, duke pasur parasysh atë që nacionalistët inkurajohen nga bojkoti i referendumit", thotë Bugajski.

Ai ka shtuar se presidenti serb Aleksandar Vuçiq dhe presidenti kosovar Hashim Thaçi kanë arritur marrëveshje për ndryshim të kufijve, kurse disa liderë shqiptarë, si në Kosovë, ashtu edhe në Maqedoni, mund të shohin mundësi për homogjenizim të mëtejshëm et-



nik, ndërlidhje të territoreve. "Nationalizmi, separatizmi do ta bëjnë vendin shumë të ndjeshëm për ndikimin e Rusisë", vlerëson Bugajski, duke shtuar se Moskë tek Maqedonia shikon si në një strehimore të saj për luftën kundër NATO-s dhe BE-së.



BURGOSJA E GRUEVSKIT

# ÇKA THONË EKSPERTËT?

Sipas interpretimeve të eksperteve juridik, me miratimin e vendimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i shkallës së parë hynë në fuqi kurse Gruevski do ta ketë patjetër të paraqitet në burg



Shkup, 7 tetor - Ekspertët juridik Zvonko Davidoviq dhe Besa Arifi, lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit për dënimin e ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, vlerësojnë se asgjë nuk mund ta ndalojë ekzekutimin e dënimit me burg, përveç mjeteve të jashtëzakonshme juridike. Ata thonë se Gruevski mund t'i shfrytëzojë këto mjete vetëm në rast të përmbushjes së kushteve të caktuara të parapara me ligj.

Eksperti juridik Davidoviq, thotë se ish-kryeministri Nikolla Gruevski ka të drejtë për ankesë dhe kërkesë për rishqyrtim të vendimit të Gjykatës së Apelit për dënimin me burg. Megjithatë Davi-

doviq konsideron se kjo ankesë përsëri nuk do ta vonoj ekzekutimin e dënimit.

"Gruevski tani mund të mbrohet me mjete juridike të jashtëzakonshme. Ato janë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkesë deri në Gjykatën Supreme për shqyrtimin e vendimit. Por, asgjë nga kjo nuk do ta zvarris mbajtjen e dënimit", tha Davidoviq në prononcim për portalin A1on.mk.

Nga ana tjetër juristja Besa Arifi konsideron se ai nuk mund të ankohet, megjithatë ai mund të shfrytëzojë vetëm ndonjë mjet të jashtëzakonshëm juridik.

"Pasi që bëhet fjalë për dy vjet

burg domethënë se ai është gjetur si fajtor në shkallë të dytë dhe aty përfundon e drejta për ankesë. Ai nuk ka të drejtë të ankohet më, për shkak që procedura në atë vendim nuk është tri shkallëshe por është dy shkallëshe. Ai mund të ankohet vetëm nëse dënohet me burgim të përgjeshëm ose nëse shkalla e dytë e ka dënuar kurse shkalla e parë e ka shpallë si të pafajshëm. Ndërkaq kushtet për ankesë në shkallën e tretë nuk përmbushen. Ai mund të përdorë ndonjë mjet të jashtëzakonshëm juridik mirëpo me çfarë arsytimi nuk e di. Ai mjeti i jashtëzakonshëm juridik e ndalon ekzekutimin e dënimit" tha Arifi.

Sipas interpretimeve të eksperteve juridik, me miratimin e vendimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i shkallës së parë hynë në fuqi kurse Gruevski do ta ketë patjetër të paraqitet në burg.

Sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve, vendimi bëhet i ekzekutueshëm kur pas vlefshmërisë së tij nuk ekzistojnë pengesa të përcaktuara që janë të parapara me ligjin për ekzekutimin e sanksioneve.

"Dita e paraqitjes në institucion do të përcaktohet në atë mënyrë që personi i dënuar të mbetet së paku tetë dhe jo më shumë se 13 ditë nga data e pranimit të aktit vijues", thotë ligji.



## Në Maqedoni vazhdon dhuna ndaj fëmijëve

Shkup, 7 tetor - Gjithsej 69 fëmijë kanë qenë viktimë e dhunës familjare edhe atë vetëm në gjashtë mujin e parë të vitit.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në pesë vitet e fundit ka rritje të numrit të rasteve të dhunës. Në vitin 2014 kishte 131 raste ndërsa në vitin 2018 (deri në qershor) – 69 raste. Nga Ministria paralajmërojnë reforma në legjislativen e kësaj fushe, ndërkaq aktualisht për mbrojtjen e viktimave Qendra për Punë sociale ndërmerr një sërë masash, si: mbrojtje shëndetësore, intervenim dhe trajtim psiko-fizik, ndihmë familjes për arsim të fëmijës.

UNIVERSITETET PRIVATE

## MUNDËSI MË TË MËDHA PËR STUDENTËT

Studentët dhe profesorët nga universitetet private shprehin se universitetet private ofrojnë mundësi më të mira dhe më cilësore për studentët. Rëndësi të madhe për ta ka praktika dhe bashkëpunimet jashtë vendit si dhe punësimi, që në shumicën e rasteve fakulteti u ndihmon rreth punësimit.



dime dhe punësim në krahasim me atë se çka ofrojnë universitetet shtetërore. Edukimi universitar siç dihet është vendimtar për përparimin dhe zhvillimin e një shoqërie, kombi dhe rrjedhimisht edhe të një shteti. Prandaj zgjedhja e cilësisë në arsimin universitar është dilema më e madhe e cila vë në udhëkryq nxënësit për të vendosur mes universiteteve private dhe atyre publike. Të dhë-

nat nga Enti Shtetëror i Statistikës tregojnë se në vitet e fundit interesi për regjistrim në fakultete private është i njëjtë dhe shkon nga 12 në 13 për qind.

Në konferencën ndërkombëtare të mbajtur në Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik theks të veçantë studentët nga e gjithë bota kanë vënë mbi cilësinë dhe mundësinë në arsim. Ndërkaq për gazetën Koha Arta Qerimi

studente e këtij universiteti u shpreh se mundësitë e të studiuarit në universitetet private janë më të mëdha dhe më me perspektivë.

"Ne ligjëratat i zhvillojmë në gjuhën angleze, përkundrajt kësaj mësojmë edhe gjuhë të tjera siç është gjuha turke e cila na hap mundësi për më shumë punë. Kemi mundësi më të mira praktike sepse fakulteti na mundëson praktikë edhe jashtë vendit dhe kemi bashkëpunime me firma të ndryshme në të cilat shumë studentë pas përfundimit të fakultetit i kanë pranuar në punë", tha Qerimi.

Mes të tjerash ajo shtoi se çdo vit studentët kanë mundësi të shkëmbimit jashtë Maqedonisë dhe kjo shërben si një përvojë e mirë për ti shkëmbyer përvojat e tyre dhe mësuar diçka nga vendet tjera. Por me anë të kësaj krijojnë lidhje të reja dhe hapin dyert për punësim jashtë vendit.

Ndërsa në ueb faqen e Univer-

sitet Amerikan rektori i këtij fakulteti kishte listuar disa arsye se pse duhet studentët të zgjedhin këtë fakultet për shkak të kushteve dhe cilësive të mira që posedon, bashkëpunimit me firmat e ndryshme që u japin mundësi studentëve për punësim më të lehtë si dhe shumë benefite të tjera. Në deklaratën e tij ai kishte theksuar se 90% e të diplomuarve në këtë fakultet për më pak se gjashtë muaj pas përfundimit të fakultetit kishin gjetur punë.

Për studentët në universitetet shtetërore shuma në këto universitete është tejet e lartë për standardet në Maqedoni, për këtë arsye shumica e këtyre studentëve për zgjedhjen e tyre për universitete e kanë të vendosur që në start.

Ndërkaq një vit në universitetet private në Maqedoni mund të kushtojë më shumë se 2500 euro duke llogaritur të gjitha shpenzimet e mundshme si tekste shkollore, uniforma, ekskursionet dhe shumë shpenzimet tjera.

Koha

Remzije BILALLI

Shkup, 7 tetor - Studentët në Universitetet private vlerësojnë se kanë mundësi më të mira për stu-



Aneksi i fundit përfundimtar për ndërtimin e autostradës Kërçovë-Ohër është në fazën përfundimtare, ndërsa janë kah fundi edhe negociatat me kompaninë kineze Sinhidro për vendosjen e çimit të fundit të kostos së këtij aksi rrugor. Në tërësi do të respektohen afatet e reja për përfundimin e autostradës deri më vitin 2021

EVITOHEN LËSHIMET E PROJEKTIT

# AUTOSTRADA KËRÇOVË-OHËR GATI NË 2021



Koha Fisnik Pasholli

Shkup, 7 tetor - Autostrada Kërçovë Ohër, pritet të përfundojë më vitin 2021. Burime qeveritare thonë se me marrëveshjet e reja dhe revidimin e tërësishëm të dokumentacionit projektues dhe teknik, do të ndërtohet autostrada që tërësisht i plotëson standardet ndërkombëtare. Pritet që me aneksin e tretë të marrëveshjes që është në fazë përfundimtare të zgjidhen të gjitha dilemat rreth trasesë dhe zhdëmtimit të truallit. Për shkak të problemeve me dokumentacionin jo të plotë projektuesi u vonua ndërtimi i rrugës, ndërsa realizuesi kryesor i punëve në teren kompania kineze "Sinhidro", kërkoi 152 milion euro shtesë vetëm për përfundimin e tunelit të gjatë 4 kilometra tek lokaliteti Preseka, ndërsa afër 90 milion euro të tjera janë kërkuar për harxhimet

shtesë në pikat e tjera problematike të ndërtimit. Bile analizat kanë treguar se materiali ku është kryhet shpimi i tunelit "Preseka" tek fshati Verbjan, kushtëzon çmim më të lartë të ndërtimit për shkak se tuneli, ishte parashikuar të ndërtohet mbi një shkëmb pa hulumtime paraprake gjeologjike, ndërsa tani terreni dikton çmim më të lartë ndërtimi që duhet të harmonizohet me partnerin kinez të ndërtimit.

Kjo rrugë e rëndësishme që nga fillimi i ndërtimit ballafaqohet me probleme të ndryshme ku fillimisht nuk ishin parashikuar hyrje-dalje ndaj rrugëve lokale, ndërsa një pjesë e rrugës ishte e parashikuar të ndërtohet mbi rezervuarin që furnizon Kërçovën me ujë.

Në ndërkohë, pas një viti konsultimesh me ekspertë vendor dhe të huaj, projekti ka marrë dritë je-

shile nga qeveria në aspektin financiar dhe teknik.

"Kjo autostradë kishte vështirësi serioze lidhur me dokumentacionin teknik dhe projektet e përfunduara të ndërlydhjeve me vendbanimet e ndryshme, apo tunelet e ndryshme. Pasi kemi harxhuar një vit, mund të them kjo nuk një kohë e humbur, për shkak se të gjitha projektet janë sjellë në gjendje teknike të drejtë. Njëherazi kemi zvogëluar edhe çmimet midis realizuesve kinez dhe kompanive vendore. Dallimi në çmime më parë ishte mbi 50 për qind, ndërsa tani ai është zvogëluar në 10 për qind. Të gjitha kursimet edhe tek punimet shtesë edhe tek tuneli do të sjellin harxhime më të ulëta prej 70 deri 100 milion euro", thotë zëvendës kryeministri për çështje ekonomike, Koço Angjushev. Sipas tij, aneksi i

fundit përfundimtar për ndërtimin e autostradës Kërçovë-Ohër është në fazën përfundimtare, ndërsa janë kah fundi edhe negociatat me kompaninë kineze Sinhidro për vendosjen e çimit të fundit të kostos së këtij aksi rrugor. Pas miratimit të marrëveshjes në qeveri, pritet që për të debatohet deputetët dhe të votojnë ndryshimet e propozuara nga qeveria para mbajtjes eventuale të zgjedhjeve parlamentare. Pritet që të përgatitet edhe dinamikë e qartë se si do të zhvillohen punët ndërtimore si dhe tjetërsimin e pronave të qytetarëve.

Drejtori i Ndërmarrjes Publike të Rrugëve shtetërore, Zoran Kitinov, shpreson se në tërësi do të respektohen afatet e reja për përfundimin e autostradës deri më vitin 2021, ndërsa paralajmëroi se disa akse rrugore do të lëshohen edhe më herët në përdorim.

"Qëllimi i jonë është që disa pjesë të rrugës prej Ohrit dhe deri te tuneli të lëshohen parciaisht në përdorim pas përfundimit të ndërtimit të tyre. Por, kjo nuk nënkupton lëshimin në përdorim të një apo dy kilometrave por, 5, 10 apo 15 kilometra që do të mundësojë edhe ngarkesën më të vogël të trafikut", thekson Kitinov.

Ndryshe, autostrada Kërçovë-Ohër filloi të ndërtohet në 2014-ën dhe duhet të jetë gati në shkurt të vitit 2018. Prokuroria publike Specia-

le në bazë të indikacioneve nga përgjimet jolegale apo "bombat", hapi rastin kundër ish funksionarëve të pushtetit të dyshuar për marrjen e mitës si dhe për mënyrën e udhëheqjes së procedurës së tenderit.

Nga ana tjetër edhe Enti Shtetëror i Revizionit konstatoi se ndërtimi i autostradave të reja po zhvillohet me tempo të ngadalshme, ekziston vonesë e punëve ndërtimore si dhe realizimit financiar të punëve të planifikuara dhe kontraktuara.

Ndryshe, autostradat Kërçovë-Ohër e gjatë 57 kilometra paraprakisht kishte kosto prej 374 milion euro, ndërsa ajo Milladovci apo nga pikë pagesa në autostradë Kumanovë-Shkup, deri në Shtip e gjatë 47 kilometra kishte vlerë 206 milion euro. Të dyja me kalimin e kohës tejkaluan buxhetin fillestar për ndërtimin e tyre. Autostrada Shkup-Shtip në vend se të lëshohet në përdorim deri më maj të vitit 2017, do të mund të përdoret deri në fund të këtij viti. Ajo ndërtohet në teren të rrafshët, shumë më të përshtatshëm ndërtimi në raport me autostradën tjetër me teren malor. Autostrada nga Kërçova për në Ohër dhe Strugë, do të jetë gjerësi prej 23 metrash, nga dy korsi në secilin drejtim dhe hapësirë për t'u ndalur makinat. Do të ketë 19 mbikalime dhe nënkalime, 22 ura si dhe një tunel prej rreth dy kilometrash.

REAGOJNË EKSPERTËT PAS RENOVIMIT TË ARKIVIT TË TETOVËS

## FASADA MODERNE, FSHIERJE E GJURMËVE HISTORIKE

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 7 tetor - Renovimi i fasadës së jashtme të objektit të Arkivit të Tetovës, ka ngjallur reagi-me të shumta tek arkitektët dhe aktivistët e shumtë në qytetin e Tetovës. Ata janë shprehur të shqetësuar se intervenimet në fasadën e këtij objekti klasik, janë jashtë çdo norme dhe tendencë e re për të zhdukur gjurmët historike të qytetit të Tetovës. Sipas tyre, përderisa kishim një tendencë në Shkup, ku objektet klasike mbuloheshin me fasadë prej barokut, në Tetovë tendenca është e kundërt, objektet me vlerë historike mbulohen me fasadë moderne. "Kjo çfarë ndodh në Tetovë me intervenimin në objektin e Arkivit Historik në Tetovë me vënien e alubond fasades në një objekt historik është e papërgjegjshme edhe e pamenduar. Kemi një fenomen ku në projektin "Shkupi 2014" objektet moderne dhe postmoderne mvishen me fasada neoklasike ndërsa në Tetovë ekstremisht tjetër, ku objektet klasike mvishen me fasada joadekuat dhe bëhen intervenime të papërshtatshme", deklaroi Merita Maksuti, arkitekte.

Ka reaguar edhe Behixhudin Shehapi, ekspert i trashëgimisë kulturore nga periudha osmane dhe këshilltar shtetëror për mbrojtjen e trashëgimisë. "Me këtë, ky objekt humbet autencitetin. Elementët në fasadë, profilimet gjeometrike, aplikimet në gurë, si ka-

trorët sferikë, komponimi hyrës dhe ngjyra karakteristike e suvatimit janë karakteristika të arkitekturës së kësaj periudhe. Të këtyra janë edhe ndërtesat e Vilajetit të Kosovës në Shkup, ndërtesa e Kongresit të Alfabetit në Manastir dhe shumë objekte të kësaj periudhe në qytetin e konsujve, restaurimi i të cilëve është trajtuar në kuadër të ligjeve dhe procedurës ekzistuese për restaurim dhe konservim ose rikonstruim të monumenteve" thotë Behixhudin Shehapi, ekspert i trashëgimisë kulturore nga periudha Osmane dhe njëkohësisht këshilltar për mbrojtjen e monumenteve. Përderisa institucionet nuk kanë dalur me qëndrim zyrtar se ky objekt është në listën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, megjithatë sipas ekspertëve humbja e identitetit të objektit të këtyra është një skandal dhe shëmtim që i bëhet qytetit të Tetovës. "Një qytet në plotkuptimin e fjalës e bëjnë qytet objektet referente ose nishanet apo internacionalisht të njohur si landmarks. Në Tetovë kemi disa ashtu objekte të cilët nuk i takojnë periudhës Osmane dhe te njejtë duhet ruajtur dhe kultivuar në mënyrë institucionale dhe duhet që të kthehen në gjendjen e mëparshme", thotë Maksuti. Për Shehabin, me këta intervenime prishet imazhi i qytetit. "Ky intervenim nuk mund të tolerohet, sepse bastardohet një traditë, një kulturë dhe një kontinuitet në stilet arkitekturale. Tetova nuk

posedon shumë objekte të këtyra që në mënyrë aq të lehtë dhe me mënyra paushale të prishet imazhi i qytetit, i cili e ka peshën e vet historike. Duhet të respektohet ligji, të përgatitet projekt për restaurimin e fasadës, të kalojë ekspertiza në institucionet kompetente dhe në fund, pasi të sigurohet leja për konservim, të fillojë riparimi. Në të kundërtën, çdo ndërmarrje tjetër është joligjore dhe shumë nënçmuese për shkencën e arkitekturës restauruese dhe identitetin kulturor e historik të Tetovës", thotë Behixhudin Shehapi.

Ndërkohë, Ngadhnjim Memeti, disenjator grafik dhe aktivist i shoqërisë civile, thotë se jetojmë në kohë të çmendura, ku me projektin "Shkupi 2014" objektet e arkitekturës moderne të shekullit 20 u mbështjellen me fasadë barok për të sajuar një identitet të rreme dhe të paqenë, ndërsa sot Gruevizimi në Tetovë implementohet në kahje të kundërt, shlyhet dhe tjetërsohet identiteti i vjetër me fasadë të reja.

"Veprimi i fundit me fasadën e ndërtesës së arkivit të qytetit të Tetovës është tendencioz, duke qenë edhe në procedurë për tu shpallur objekt i trashëgimisë kulturore. Qëllimi është ta le pa histori dhe ta shpërfill edhe atë trashëgimi kulturore që ka mbetur nga e kaluar në këtë qytet. Projekti i rrënimt të trashëgimisë kulturore të qyteteve tona ka filluar që nga koha e regjimit komunist duke vazhduar edhe sot në trajta tjera, me betoni-



zimin masiv dhe promovimin e tallavasë në urbanizëm dhe arkitekturë, duke demotivuar kështu edhe gjeneratat që vijnë. Tetova po shpërfitohet si qytet dhe lirisht mund të merr çmimin për "Qytetin më të shemtuar në rajon", qytetin me shesh kaotik e hapësira të uzurpuara, ku vendin e trashëgimisë kulturore e zë pluhuri si dhuratë e pushtetit lokal", thotë Memeti.

Në ndërkohë, përgjegjësit e Arkivit në Tetovë kanë shmangur kontaktin me gazetarë. Ata kanë thënë se bëhet fjalë për renovim të objektit por duke refuzuar që të japin sqarime por vetëm kanë thënë se renovimet kryhen nga Qendra në Shkup, dhe se 32 vite nuk është bërë asnjë ndërhyrje. Poashtu ata kanë refuzuar të japin përgjigje se a kanë marrë leje nga Qendra Nacionale për Konservim dhe Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore për të kryer punime. Deri më tani, ende nuk ka reagim nga ana e Ministrisë së Kulturës.





## Republika e Maqedonisë Ministria e financave Drejtoria për zbulim financiar

Numër. \_\_\_ - \_\_\_/\_\_\_

Data: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, Shkup

Në bazë të nenit 20-g paragrafi 1 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/2014, 27/14, 199/14 dhe 27/16), nenit 22 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), nenit 74 dhe 75 të Ligjit për parandalim të larjes së parave dhe financim të terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 120/18) Ministria e financave – Drejtoria për zbulim financiar publikon:

### SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 1 (një) personi në Ministrinë e financave – Drejtorinë për zbulim financiar për kohë të pacaktuar

Ministria e financave – Drejtoria për zbulim financiar publikon shpallje publike për punësim të 1 (një) personi për kohë të pacaktuar në pozitën në vijim:

1. Udhëheqës të Departamentit për çështje juridike dhe administrative – zbulues udhëheqës financiar, në Sektorin për mbikëqyrje, rregullativë dhe bashkëpunim ndërkombëtar, shifra UFR 0210A3001 – 1 (një) realizues.

Kandidati duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Drejtorinë për zbulim financiar:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i shëndoshë (i aftë) psiko-fizikisht dhe me predispozita për kryerje të punëve të zbuluesit financiar (vërtetim të dhënë nga ana e institucionit të caktuar shëndetësor);
- Nën mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidati duhet të përmbushë kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Drejtorinë për zbulim financiar:

- Të kenë të mbaruar shkallën VI A sipas kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë VII/1 të mbaruar edhe atë:
  - Shkencat juridike ose ekonomike ose shkencat politike;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Përvojë pune prej së paku 5 vjet në profesion;

- Të ketë dëshmi (certifikatë) përkatëse jo më të vjetër se 5 vjet për njohje të gjuhës angleze:
  - a) TOEFEL IBT – së paku 74 pikë;
  - b) IELTS – së paku 6 pikë;
  - c) ILEC (Cambridge English First) – së paku niveli B2;
  - c) BULATS – së paku 60 pikë ose
  - d) APTIS – së paku niveli B2.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët i përmbushin kushtet për konkurrim.

Fletëparaqitja për punësim duhet të përmbajë:

- Të dhëna për kandidatin (emri dhe mbiemri, numri i amzës së qytetarit, data dhe vendi i lindjes, adresa e banimit, adresa elektronike e kandidatit, telefoni për kontakt, përkatësia), si dhe letër të shkurtër motivimi
- Biografi të shkurtër
- Deklaratë për përmbushje të kushteve të përgjithshme për vendin e punës (për secilin kusht veç e veç)
- Deklaratë për përmbushje të kushteve të posaçme për vendin e punës (për secilin kusht veç e veç).

Kandidati me fletëparaqitjen duhet të parashtrijë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter edhe atë:

- Dëshmi të shtetësisë;
- Dëshmi se nuk u është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
- Vërtetim të dhënë nga institucioni i caktuar shëndetësor;
- dëshmi (certifikatë) përkatëse jo më të vjetër se 5 vjet për njohje të gjuhës angleze:
  - a) TOEFEL IBT – së paku 74 pikë;
  - b) IELTS – së paku 6 pikë;

- c) ILEC (Cambridge English First) – së paku niveli B2;
- ç) BULATS – së paku 60 pikë ose
- d) APTIS – së paku niveli B2.

- Letër të shkurtër
- Letër motivimi.

Orari i kohës së punës:

- Orët e punës në javë: 40;
- Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte, me fillim mes orës 7:30-8:30 dhe përfundim të orarit të punës mes 15:30-16:30.

Shuma në të holla e pagesës fillestare për vendet e punës është 33.813,00 denarë.

Realizimi i procedurës për zgjedhje të kandidatëve do të bëhet përmes përzgjedhjes administrative (kontrollimit të të dhënave të parashtruara në fletëparaqitje), provim me shkrim dhe intervistës.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar ditën e vet publikimit).

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet drejtpërdrejtë në arkivin e Drejtorisë për zbulim financiar në rr. Sheshi Presveta Bogorodica nr. 3, kati 6 Shkup (me shenjë "për shpallje për punësim").

Telefoni për kontakt: 3297 540

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Drejtor

Blazho Trendafilov



Republika e Maqedonisë  
Komuna e Tetovës  
1200 Tetovë, rr. "Dervish Cara" nr. 68  
e-mail: komunate@mt.net.mk

Nr. 22-490  
05.10.2018  
Tetovë

Në bazë të nenit 137 paragrafi 1 dhe nenit 134 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për ndërtim ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 130/09, 124/2010, 18/2011, 36/2011, 54/2011, 13/2012 dhe 39/2012- teksti i pastuar), 144/13, 25/13, 70/13, 137/13, 163/13, 27/2014, 28/2014, 42/2014, 115/2014, 149/2014, 187/2014 dhe 44/2015, 129/2015, 217/2015, 226/2015, 30/2016, 31, 2016, 39/2016 dhe 71/2016), inspektori i autorizuar i ndërtimit i komunës së Tetovës, mori:

#### AKTVENDIM

1. URDHËROHET investitori, **Shoqata tregtare për tregti dhe shërbime TREVZHR MAUNTAJN PROXHEKT SHPKPV Tetovë NUT 4028013520182 me seli në rr. Boris Kidric nr. 201 Tetovë ku administrues është Gomil Tishka nga Stambolli me NUAQ TR-U no. 760821, që në afat prej 2 (dy) ditësh pas pranimit të këtij Aktvendimi të MBULOJE themelet e hapura me dimensione 8.00 x 5.00 m. me thellësi prej 60 cm. dhe 8 grupa për themelet të veçanta me dimensione 50.00 x 50.00 m me thellësi prej 50 cm që gjinden në KP.2205 KK Shipkovice-jasthtë r.a komuna Tetovës në v.q Alivaka" ne masivin malor Sharr, komuna e Tetovës dhe ta kthejë vendin në gjendje e mëpërpashme për të cilin ndërtim nuk posedon leje ndërtimi.**
2. Në qoftë themelet e hapura me dimensione 8.00 x 5.00 m. me thellësi prej 60 cm. dhe 8 grupa për themelet të veçanta me dimensione 50.00 x 50.00 m me thellësi prej 50 cm që gjinden në KP.2205 KK Shipkovice-jasthtë r.a komuna Tetovës në v.q Alivaka" ne masivin malor Sharr, komuna e Tetovës nuk mbulohen në afatin e caktuar, do të procedohet ndaj përbarimit të dhunshëm administrativ ndaj ndërtimit.
3. Shpenzimet për realizimin e Aktvendimit kompensohen nga pronari.
4. Ankesa kundër këtij Aktvendimi nuk e anulon përbarimin e aktvendimit.

#### Arsyetim

Inspektori i autorizuar i ndërtimit i komunës së Tetovës, duke proceduar sipas obligimit zyrtar, bëri inspektim në vendndodhje me dt. 18.09.2018 në ora 10<sup>00</sup> në KP.2205 KK Shipkovice-jasthtë r.a komuna Tetovës në v.q Alivaka" ne masivin malor Sharr, komuna e Tetovës, për çka është konstatuar me procesverbal për konstatim nr. 22-490 dt. 03.09.2018 se Shoqata tregtare për tregti dhe shërbime TREVZHR MAUNTAJN PROXHEKT SHPKPV Tetovë NUT 4028013520182 me seli në rr. Boris Kidric nr. 201 Tetovë ku administrues është Gomil Tishka nga Stambolli me NUAQ TR-U no. 760821, ka filluar me pune ndërtimore duke hapur themelet me dimensione 8.00 x 5.00 m. me thellësi prej 60 cm. dhe 8 grupa për themelet të veçanta me dimensione 50.00 x 50.00 m me thellësi prej 50 cm që gjinden në KP.2205 KK Shipkovice-jasthtë r.a komuna tetovës në v.q Alivaka" ne masivin malor Sharr, komuna e Tetovës.

Në vendin e punës udhëheqësit të punitorëve të ndërtimit i është dorëzuar ftesë për palë me dt. 18.09.2018.

Në datën 21.09.2018 përfaqësues i investitorit është përgjigjur ftesës.

Ku përfaqësuesit të investitorit i është bërë me dije se në këtë moment punët ndërtimore të hapjes së themeleve me dimensione 8.00 x 5.00 m. me thellësi prej 60 cm. dhe 8 grupa për themelet të veçanta me dimensione 50.00 x 50.00 m me thellësi prej 50 cm që gjinden në KP.2205 KK Shipkovice-jasthtë r.a komuna Tetovës në v.q Alivaka" ne masivin malor Sharr, komuna e Tetovës që ndërtohen paraqasin ndërtim pa leje dhe duhet nga ana e tyre menjëherë me vet dëshirë ta kthejnë vendin në gjendje e mëpërpashme ose në të kundërtën nga ana e inspektorit të autorizuar të ndërtimit do të merren veprime administrative në pajtim me Ligjin për ndërtim.

Në bazë të inspektimit në vendngjarje dhe kontrollimit të palëve është përpiluar procesverbal për konstatim në hapësirat zyrtare të inspektorit të autorizuar të ndërtimit në pajtim me nenin 37 paragrafi 3 të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 50/210, 162/210, 157/2011, 147/2013, 41/214, 33/2015, 193/2015 u 53/2016).

Me që gjatë mbikëqyrjes së rregullit inspektuese është vërtetuar se investitori, **Shoqata tregtare për tregti dhe shërbime TREVZHR MAUNTAJN PROXHEKT SHPKPV Tetovë NUT 4028013520182 me seli në rr. Boris Kidric nr. 201 Tetovë ku administrues është Gomil Tishka nga Stambolli me NUAQ TR-U no. 760821, kanë filluar me pune ndërtimore duke hapur themelet me dimensione 8.00 x 5.00 m. me thellësi prej 60 cm. dhe 8 grupa për themelet të veçanta me dimensione 50.00 x 50.00 m me thellësi prej 50 cm që gjinden në KP.2205 KK Shipkovice-jasthtë r.a komuna Tetovës në v.q Alivaka" ne masivin malor Sharr, komuna e Tetovës për të cilin ndërtim nuk posedon leje ndërtimi të plotfuqishme, inspektori i autorizuar i ndërtimit në pajtim me nenin 134 alineja 1 të Ligjit për ndërtim ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 130/2009, 124/2010, 18/2011, 36/2011, 54/2011, 13/2012 dhe 39/2012- teksti i pastuar, 144/2013, 25/2013, 70/2013- teksti i pastuar, 137/2013, 163/2013, 27/2014, 28/2014, 115/2014, 149/2014, 187/2014 dhe 44/2015, 129/2015, 226/2015, 30/2016, 31, 2016, 39/2016 dhe 71/2016), mori aktvendim si në dispozitiv.**

Në rastin konkret, ankesa e dekluar kundër Aktvendimit të shkallës së parë me të cilën urdhërohet që të kthehet toka në gjendje e mëpërpashme në pajtim me nenin 137 paragrafi 4 të Ligjit për ndërtim ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 130/2009, 124/2010, 18/2011, 36/2011, 54/2011, 13/2012 dhe 39/2012- teksti i pastuar, 144/2013, 25/2013, 70/2013- teksti i pastuar, 137/2013, 163/2013, 27/2014, 28/2014, 42/2014, 115/2014, 149/2014, 187/2014 dhe 44/2015, 129/2015, 217/2015, 226/2015, 30/2016, 31, 2016, 39/2016 dhe 71/2016), nuk e anulon përbarimin e aktvendimit.

UDHËZIM: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese përmes komunës së Tetovës në afat prej 8 ditëve nga pranimi i këtij Aktvendimi deri te komisioni shtetërorë i shkallës së dytë në fushën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtës.

Ankesa taksohet me 250,00 denarë pulla administrative.

INSPEKTORI I AUTORIZUAR I NDRËTIMIT  
Gzim Ganiu, idn

Në bazë të nenit 156,157 al 1, neni 158 , neni 159 dhen neni 160 prej ligjit për kujdes shëndetësor (Gazeta zyrtare e RM nr. 43/12 ,145/12, 87/13,164/13, 39/14, 43/14,188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16),neni 19, 22 dhe 23 prej ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 62/2205 me ndryshime dhe plotësime të Gaz.Zyrtare e RM nr. 167/2015 , nr. 27/2016 dhe 120/2018), dhe njoftim për miratimin e mjeteve financiare për punësim prej Ministrisë të Financave të RM me numër 18-10110/2 dhe nr 18-10116/2 prej 05.10.2018 I.S.H.P Spitali i Përgjithshëm Strugë shpall:

### SHPALLJE PUBLIKE

Njoftimi publik shpallet për punësimin e punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar I.S.H.P Spitali i Përgjithshëm Strugë ka nevojë për punësimin e 18 (tetëmbëdhjetë) për persona në kohë të pacaktuar për punët e mëposhtme:

1. Mjek i medicinës - 8 zbatues
2. Farmacist i diplomuar - 2 zbatues
3. Biokimist - 1 zbatues
4. Teknik farmaceutik - 1 zbatues
5. Motër medicinale - 6 zbatues

1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me ligjin për kujdes shëndetësor:

- Të jetë nënshkollësi i RM
- Të jetë i rritur
- Të ketë afësi shëndetësore
- Nuk i është dhënë ndalesë e plotfuqishme për kryerjen e profesionit,aktivitetit ose detyrë.

Për kandidatët për vendin e punës ndërkohë 1:

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj prej pikës 1 kandidatët për vendin e punës mjek i medicinës duhet të plotësojnë kushtet e veçanta:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë me më se paku 240 kredi fituar sipas SETK ose mbarimi i shkallës VII/1;
- Ta ketë dhënë provimin shtetëror;
- Licencë pune valide;
- Dëshmi për njohjen e njërës prej gjuhëve të huaja në EU-anglisht,frëngjisht,gjermanisht;
- Me përvojë pune ose pa përvojë pune

Për kandidatët për vendin e punës ndërkohë 2:

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj prej pikës 2 kandidatët për vendin e punës Farmacist i diplomuar duhet të plotësojnë kushtet e veçanta:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë me më se paku 240 kredi fituar sipas SETK ose mbarimi i shkallës VII/1;
- Ta ketë dhënë provimin shtetëror;
- Licencë pune valide;
- Dëshmi për njohjen e njërës prej gjuhëve të huaja në EU-anglisht,frëngjisht,gjermanisht;
- Me përvojë pune ose pa përvojë pune

Për kandidatët për vendin e punës ndërkohë 3:

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj prej pikës 3 kandidatët për vendin e punës Biokimist duhet të plotësojnë kushtet e veçanta:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë,fakultetin e matematikës natyrore,drejtimi kimi dhe biologji, me më se paku 240 kredi fituar sipas SETK ose mbarimi i shkallës VII/1;
- Ta ketë dhënë provimin shtetëror;
- Dëshmi për njohjen e njërës prej gjuhëve të huaja në EU-anglisht,frëngjisht,gjermanisht;
- Certifikatë pune për programe kompjuterike;
- Me përvojë pune ose pa përvojë pune

Për kandidatët për vendin e punës ndërkohë 4:

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj prej pikës 4 kandidatët për vendin e punës Teknik farmaceutik duhet të plotësojnë kushtet e veçanta:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë teknik farmaceutik AMP shkallës -IV/;
- Ta ketë dhënë provimin shtetëror;
- Dëshmi për njohjen e njërës prej gjuhëve të huaja në EU-anglisht,frëngjisht,gjermanisht;
- Certifikatë pune për programe kompjuterike;
- Me përvojë pune ose pa përvojë pune

Për kandidatët për vendin e punës ndërkohë 5:

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj prej pikës 5 kandidatët për vendin e punës Motër medicinale duhet të plotësojnë kushtet e veçanta:

- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm mjekësor, Motër medicinale AMP shkallës -IV/;
- Ta ketë dhënë provimin shtetëror;
- Certifikatë pune për programe kompjuterike;
- Me përvojë pune ose pa përvojë pune

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikim me biografi të shkurtër (CV) dhe kontakt tel;
  - Certifikatën e nënshkollësisë në origjinal ose të noterizuar
  - Certifikatë mjekësore jo më të vjetër se 6 muaj origjinal ose të noterizuar
  - Certifikatë se nuk ka ndalesë të plotfuqishme për kryerjen e profesionit
  - Për kandidatët ndër pikat 1,2,3 Diplomë ose Certifikatë që ka përfunduar arsimin e lartë me sukses mesatar,origjinal ose të noterizuar
  - Për kandidatët ndër pikat 4,5 Diplomë ose Certifikatë që ka përfunduar arsimin e mesëm me sukses mesatar,origjinal ose të noterizuar
  - Certifikatë se e ka kryer provimin shtetëror origjinal ose të noterizuar
  - Për kandidatët ndër pikat 1 dhe 2 licencë të vlefshme për punë origjinal ose të noterizuar
  - Për kandidatët ndër pikat 1,2,3 dëshmi për njohurin e njërës prej gjuhëve të huaja nënë EU-anglisht,frëngjisht,gjermanisht;
  - Për kandidatët ndër pikat 3,4,5Certifikatë pune për programe kompjuterike;
  - Kandidatët të cilët kanë kryer arsimin jashtë shtetit duhet të dorëzojnë
  - Nostifikim diplome me arsim të përshtatshëm;
  - Dokument për ekuivalencën e vlerësimit të lësuar nga Ministria e Arsimit;
- Koha e përditshme e punës prej 8 orësh(në ndërrime sipas orarit të përcaktuar nga punëdhënësi) përndryshe 40 orë pune në javë. Aplikimin me dokumentet e nevojshme të dorëzohen te arkivi i I.S.H.P Spitali i Përgjithshëm Strugë ke j 8-Noemvri p.n Strugë me etiketë për shpallje publike për punësim, në afat prej 5 ditësh,Illogaritur nga data e shpalljes publike në gazetat zyrtare „Sloboden pečat,dhe „Koha...“ Aplikimet që nuk janë të kompletuara dhe që nuk janë dorëzuar në kohë nuk do të shqyrtohen prej komisionit për selektimin e kandidatëve. Përzgjedhja e kandidatëve do të kryhet sipas neni 160 dhe neni 161 prej ligjit për kujdes shëndetësor. Për përzgjedhjen e bërë të gjithë kandidatët do të njoftohen.

I.S.H.P Spitali i Përgjithshëm Strugë



FAMILJET ME KREDI NË SHQIPËRI

# MBI 30% TË TË ARDHURAVE SHKOJNË PËR KËSTET

Gati një e treta e familjeve shqiptare kanë një hua për të shlyer, kryesisht ndaj bankave. Banka e Shqipërisë gjatë një anketimit me rreth 1200 familje në të gjithë vendin për testuar qëndrueshmërinë e tyre financiare gjeti se në tremujorin e dytë të 2018 këstet mujore për shlyerjen e huave në familje zënë 10deri mbi 30 për qind të të ardhurave mujore.

Sipas vërtetimit rreth 28% e familjeve deklaruan se kanë hua për të paguar dhe kjo peshë ka mbetur e njëjtë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë, por nën mesataren historike të vlerave të vërtetimit.

Rreth 60% e familjeve huamarrëse deklarojnë se "aftësia e tyre paguese" nuk ka ndryshuar, ndërsa pjesa tjetër deklarojnë kryesisht përkeqësim krahasuar me 6-mujorin paraardhës dhe një vit më parë.



Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe i shpenzimeve të familjeve është rritur gjatë periudhës së vrojtuar, por rritja e shpenzimeve ka qenë më e theksuar, duke rezultuar në ngushtim të balancës financiare (të ardhura – shpenzime).

Sipas analizës së Bankës, kjo strukturë ka vijuar të zhvendoset

në favor të huamarrjes formale, krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Në përbërjen e tepicës sipas monedhës, rezultojnë se 84% e saj deklarohet në lekë dhe 16% në euro.

Sipas qëllimit të përdorimit, rreth 35% e tepicës së huasë deklarohet për blerjen ose riparimin e një prone, 41% për zhvillimin e

biznesi dhe vetëm 5% për konsum. Gjatë periudhës së vrojtuar, teprica e huasë me qëllim zhvillimin e një biznesi ka qenë në rritje, ndërsa për dy zërat e tjerë ka rezultuar në rënie.

Familjet huamarrëse vlerësojnë rënie të këstit të huasë gjatë periudhës referuese, duke reflektuar prirjen rënëse të normës së peshuar të interesit të kredisë për individët.

Për gjysmën e dytë të vitit 2018, shumica e familjeve huamarrëse (rreth 74%) nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të të përgjigjurve tregon për një përkeqësim të lehtë.

Mundësia për të marrë hua gjatë pjesës së dytë të vitit 2018, vlerësohet pothuaj e njëjtë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por në rënie krahasuar. /BalkanWeb

TREGTIA MIDIS RUSISË DHE INDISË



## Deri në vitin 2025 - 30 mld dollarë

Vëllimi i tregtisë midis Rusisë dhe Indisë ka tejkaluar 9 miliardë dollarë vitin e kaluar dhe do të rritet më tej me vendet që synojnë të nxisin tregtinë dhe të inkurajojnë investimet, sipas Presidentit rus Vladimir Putin. "Ne kemi vendosur një objektiv të rritjes së qarkullimit tregtar në 30 miliardë dollarë ... dhe rritjes së investimeve në 15 miliardë dollarë deri në vitin 2025," tha Putin një vizitë zyrtare dy-ditore në Indi.

Putin tha se zgjerimi i ndërveprimeve të tregtisë dhe investimeve është një përparësi për të dy vendet. Ai vuri në dukje se "nëse lëvizim me një ritëm të tillë, ne do të arrijmë objektivin para kohe dhe do të vazhdojmë zgjerimin".

Statistikat treguan se tregtia midis Rusisë dhe Indisë u rrit me 20 për qind në periudhën janar-korrik, duke arritur në më shumë se 6 miliardë dollarë.

Muajin e kaluar, Nju Delhi propozoi ngritjen e një zone të veçantë ekonomike për kompanitë ruse.

Më parë, të dy vendet diskutuan krijimin e një 'korridorit të gjelbër' për tranzitin e qetë të mallrave. Ata dëshirojnë të krijojnë një listë të sipërmarrësve apo kompanive, mallrat e të cilave do të përjashtohen nga inspektimet e rregullta doganore.



### Fuqizohet "Made in Germany"

Porositë industriale në Gjermani janë rimëkëmbur në muajin Gusht, ndërkohë që ngërçi në sektorin e makinave u përmirësua dhe marrëveshjet me klientët jashtë Eurozonës janë përsheptuar. Kontratat për mallrat "made in Germany" u rritën me 2%, pas një rënieje me 0.9% në muajin e kaluar, sipas Ministrisë së Ekonomisë. "Rritja e fortë e porositë nga vendet jashtë Europës vërtetohet se produktet industriale të Gjermanisë janë tejet të kërkuara në të gjithë botën, pavarësisht konfliktit tregtar", deklaroi Ministria. Sipas raportit, rritja e porositë u nxit nga një rimëkëmbje në sektorin e makinave, që kishte ndaluar nga prezantimi i një standardi të ri të ndotjes. Ndërkohë që kjo pengesë është tejkaluar, trendi pozitiv në sektorin industrial pritet të vazhdojë në tremujorin e katërt. Të dhënat vijnë paralelisht me përmirësimin e treguesit mbi ndjesinë e bizneseve në ekonominë më të madhe të Europës. Instituti i Hulumtimeve për Ekonominë Ifo, bëri të ditur në një sondazh se ndjesia e bizneseve ka mbetur e qëndrueshme në Shtator, nxitur nga shpenzimet konsumatore dhe ndërtimi. Qeveria ka projektuar një rritje me 2.3% të ekonomisë këtë vit dhe me 2.1% për 2019-ën.

## Zbulohet në Adriatik mega-rezervë gazi

Në dyshemenë e rërës së detit Adriatik ka më shumë gaz metan sesa mund të shpresohet. Dy shifra për të bërë krahasimet: sot nxirren 2.8 miliardë metër kub gaz në vit nga Adriatiku ndërsa rezervat e gjetura këto muaj të bëjnë që të mendosh se mund të nxirren në fakt 4 miliardë metër kub në vit. Kjo është shumë, krahasuar me 5.5 miliardë metër kub gaz që janë nxjerrë nga të gjitha depozitat italiane sëbashku gjatë vitit 2017.

Sipas "Isole24ore", në total, Italia ka konsumuar 75 miliardë metër kub gaz në 2017, nga të cilat 70 miliardë i kanë ardhur nga shumë larg, përmes mijëra kilo-



metrash tubacione. Muaj më parë, kompania e njohur në fushën e energjetikës ENI kishte deklaruar 2 miliardë euro investime në

Adriatik, që në Europë është një nga zonat më të pasura me metan por që shfrytëzohet me intensitetin e viteve '70./Scan-tv

## "Hilton" hap hotelin më të ri në Tiranë

Brandi botëror i hoteleve "Hilton" ka bërë investimin e parë në Shqipëri duke hapur Hilton Garden Inn në kryeqytetin shqiptar. Tregu i hotelierisë prej rreth 100 milion euro në vit është në zgjerim duke tërhequr edhe vëmendjen e gjigantit botëror, i cili pas qyteteve të rajonit si Beogradi, Zagrebi apo Podgorica, tashmë do të jetë edhe në Tiranë.

I pozicionuar në Bulevardin "Gjergj Fishta", hoteli është i vendosur vetëm dy kilometra larg qendrës së qytetit dhe vëndodhjes së bizneseve, duke ofruar qasje të lehtë tek kompanitë e biznesit dhe atraksionet e vendit.

Në vitin 2017, Shqipërinë e kanë vizituar më shumë se 5 milionë vizitorë dhe vizitorët e huaj në Shqipëri arritën numër rekord.



Me lulëzimin e turizmit, Hilton Garden Inn Tirana u ofron udhëtarëve në Shqipëri mikpritjen e markës së mirënjohur.

Të gjithë mysafirët në Hilton Garden Inn në mbarë botën akomodohen në dhoma me çmim të

përbalueshëm, pajisje moderne dhe kanë premtimin e "Hilton Garden Inn", e cila afirmon qëllimin e markës për të bërë çdo mysafir të ndihet rehat.

"Jemi të lumtur që kemi sjellë përvojën e Hilton Garden Inn në

Tiranë", tha Michael Walker, Menaxher i Përgjithshëm. "Me dhomat e tij të rehatshme, gamën e gjerë të opsioneve për ushqimin dhe hapësirat për takime dhe evente, Hilton Garden Inn Tirana synon të bëhet zgjedhja e preferuar për vizitorët në qytet.", vijoi ai.

Hapja e hotelit zgjeron ndikimin global të Hilton në më shumë se 106 vende dhe territore.

Në një intervistë për Albeu.com, Menaxheri i Përgjithshëm Michael Walker tha se bëhet fjalë për një investim 19 milion euro, i cili ofron risitë më të fundit të teknologjisë sa i përket dhomave dhe sallave të konferencave dhe sigurisht duke patur shefa, ndër më të mirët e rajonit në kuzhinë.



# Lodhja intelektuale



Nga  
Blerim REKA

Shqiptarët nuk kanë një Sartër, të cilin nuk mundi ta ndalte as Presidenti Degoll, sepse siç thoshte-“nuk arrestohet Volteri”. Atëherë, para gjysëm shekulli, lëvizja intelektuale e Sorbonës, kishte realizuar misionin e vet se: “është e ndaluar, të ndalosh”.

Sot, ndërkaq intelektualët shqiptarë nuk i ndalon askush. Jo sepse janë larg përmasave ndërkombëtare të Volterit, por mbetën edhe larg kalibrut kombëtar të: Konicës, Nolit e Merxhanit. Pas Luftës së Dytë Botërore, dy periudha profilizuan formatin e intelektualit. Në shoqëritë shqiptare komuniste, intelektualët ishin heshitur nga frika- prej persekutimit. Sot, u mekën nga joshja prej pushtetit- post komunist. Pra, nëse dje ishin ndaluar, sot ata po vetë-ndalohen.

Gjatë periudhës së parë, intelektualët madje edhe në rrethana represive, guxuan- sidomos në Kosovë- ti kundërviheshin regjimit edhe me çmimin e burgosjes. Nga Demaqi, tek “Apeli i 215 intelektualëve” e deri te shkyerja e librezave të LKJ, në gazetën “Rilindja”. Në periudhën e dytë, intelektualit, nuk e ka mbi kokë burgun, por kufizimin e parasë apo të postit. Blerja e heshtjes intelektuale, me financimin shtetëror të “projekteve madhore shkencore”, të “botimeve jetësore” apo emërimit të “këshilltarëve”; doli më efikas se ndëshkimi komunist. Vetëm pas mbylljes së rubinetës buxhetore, ata që deri dje heshtnin, sot kritikojnë. Dhe anasjelltas: ata që sot duken kritikues, mjafton një linje buxhetore, për tu ri-qetësuar.

## FORMULA BIZANTINE E MPOSHTJES SË KUNDËRSHTARIT

Në këtë çerek shekulli post-komunist, funksionoi pefekt formula bizantine e mposhtjes së kundërshtarit: bleje, nëse nuk e mund me dhunë. Pushteti post-komunist, doli më inventiv me krijimin e inxhinierignut qetësues: reketimin e intelektualëve. Por ndodhi edhe procesi i kundërt: reketimi i zyrtarëve- sidomos nga mediat e catuara, me metamorfizimin e tyre në raport me pushtetin.

Para çerek shekulli, mediumet kritikonin, pse funksionarët shtetëror kishin një shtëpi elitare: te Blloku, në Gërmi apo në Vodno. Sot, mediumet, mezi hapin temat se si me rroga buxhetore funksionerët aktual, kanë villa e hotele jashtë vendit? Ose, i mbyllin ato, posa u paguhet reketi.

Pos medias, nuk janë më mirë as organizatat jo-qeveritare. Në çerek

shekullin e fundit post-komunist, ideja për shoqërinë civile u devaluua, duke u redukuar në atë të shoqërisë shtetërore, fenomen i njohr edhe në literaturën e huaj si QNGO. Pushteti post-komunist, pra me mjeshtri gradualisht: ose bleu OJQ-të kritikuese; ose edhe vet themeloi dhe financoi kuazi OJQ, për ti kundërvyer atyre që e kritikonin. Me pak përjashtime, prijësit e shoqërisë civile, në petkun e “analistëve politik”, shtyen anësh intelektualët, ndërkohë që nga kritikuesit e pushtetit, do bëheshin edhe pjesë e pushtetit. Ata që deri dje kritikonon pushtetin, sot duan të na bindin se se vetëm ne, (por edhe vetë ata- më heret), e kishin gabim! Deri në fillim të nëtëdhjetave të shekullit të kaluar ishte, pra frika ajo që frenonte mendimin e lirë intelektual. Tek intelektualët e sotëm, frikën e zëvendësoi e kojtymja. Pushteti komunist ndaj intelektualëve kritik aplikonte diferencimin ideopolitik. Ky i sotmi- diferencimin buxhetor. Në komunizëm ndodhi vetë-censura intelektuale; pas komunizmit po ndodhë lodhja intelektuale.

Sot, intelektualët nuk burgosen, por ama as nuk i pyet kush për mendim. Madje edhe ata vetë si duket janë të lodhur nga dhënja e mendimeve, sepse kush nuk i vlerëson më ato. Pa amnistuar as vetë intelektualët, të cilët

me heshtjen konformiste, kanë po aq përgjegjësi për de-intelektualizimin e shoqërive tona.

Pse edhe ne nuk jemi vetë-kritik dhe pse në emër të solidaritetit të rrejshëm kolegial, mbyllim sytë para avancimeve të dyshimta në thirrjet akademike? Pse heshtim për plagjiaturë dhe për botimet kuazi shkencore të kolegëve tanë në “fake journals”? Pse nënshkruajmë recensionet për master e për doktorate të dyshimta?

Fundja pse bëhemi sikur nuk dijmë për diplomat false apo edhe për rritjen e gradave shkencore- madej as pa diplomë fakulteti?! Shqetësese është jo vetëm dhjamosja intelektuale e profesoratit në prag të pensionimit, por shumë më tepër e kuadrove të reja që posa hynë në komunitetin akademik. Guximi intelektual nuk nënkupton vetëm kritikë kundër pushtetit, por po aq edhe kundër devijimeve brenda vetë botës akademike. Nuk ngritet shoqëria me pseudo-intelektuale.

Jo rastësisht arsimi në shoqëritë shqiptare është në fund të rangimit europian, kurse universitetet tona zënë vendet katërshifërore klasifikuese. Pra, fajti është edhe i vetë intelektualëve, të cilët: të paligjshmen dhe jo-etiken në komunitetin e tyre akademik e pranun si legale dhe morale.

**Paradoksalisht, erdhëm në situatën: sa më shumë kritikë intelektuale, aq më i fuqishëm pushteti. Sa më tepër “intelektualizëm” verbal, aq më tepër pushtet real. Nuk mbaj mend, që intelektualët ndërruan regjimet në Ballkan; por vetëm matematikat e aleancave befasuese ndërpartiake. Si rrjedhojë, shoqëritë tona mbeten fasada të demokracisë. Janë demokracia, ku intelektualit kritikon, por askush nuk e dëgjon**



## PUSHTETI POST-KOMUNIST DOLI MË I AFTË, NË LODHJEN E INTELEKTUALËVE

Thjeshtë, intelektualët e sotëm janë të dërmuar nga përpjekja e tyre e vazhdueshme për të thënë të vërtetën, sepse pushtetet post-komuniste, në vend të pëndjekjes së tyre, aplikojnë injorimin e tyre. Çka që intelektualët në shoqëritë shqiptare kritikuan e kritikojnë politikën qeveritare? A mos i ndryshuan ato? Secili sot në FB, ka lirinë e kritikës, por cili është efekti i kësaj kritike virtuale, kur nuk ndryshon gjenden reale?

Pushteti post-komunist doli më i aftë, në lodhjen e intelektualëve: askush nuk i ndalon të kritikojnë- deri sa ata vetë të lodhen dhe të vetë-dorëzohen! Ti hyjnë politikës, si e vetmja rrugë për ti ndryshuar gjerat; u pa si mision i pamundshëm në shoqëritë tona. Ku përfunduan intelektualët e: Tiranës, Prishtinës apo Shkupit, që provuan garën politike? Kjo është përgjigja më e mirë ndaj qarqeve altruiste intelektuale që ende operojnë me modelet e nevojës për “rrugën e tretë”, apo për parti elitiste.

Në shoqëritë post-komuniste shqiptare, votat nuk fitohen me ide iluministe, por me matematikë precize elektorale, besa edhe me mbushje kutish. Si mund ta mobilozojë elektora-

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 7 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



tin një intelektual jashtë-establishmentit, karshi një partie në pushtet me gjitha atë armatë shërbyesish civil, ku qeveritë tona mbeten punëdhënësi kryesor? Prandaj BE, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore u lodhën së kërkuari prej shteteve tona reduktimin drastik të administratës shtetërore: disa fish më të fryer se numri i popullsisë së elektoratin e sigurtë të pushtetarëve?

Kujt i shërbyeka, sot, pra, shërbimi civil në Ballkan? Qytetarëve, nga paguhen taimet e rrogave të tyre? Apo atyre që janë në pushtet, në çdo cikël elektoral? Shumëzoheni atë administratë shtetërore me numrin e anëtarëve të familjeve dhe ju del elektorati i sigurtë që çdo herë do e votojë pushtetin dhe jo intelektualin. Pa llogariur këtu oligarkët e biznesit-eminencën gri të partive tona në pushtet. Prandaj, sot ndryshoi edhe perceptimi për intelektualin. Të tillë quhen ata me ngritje themelore akademike, që vendin e parë të punës e kanë ministër; shoferët në cilësi këshilltari; apo ata që falë ngjitjes së posterëve elektoral bëhen zyrtar qeveritar. Ata sot edhe mund të kenë formësimi profesional, por u mungon guximi intelektual. Shoqëritë tona kanë suficit diplomash, po deficit dijesh. Madje edhe pas tri dekadash nga perëndimi i kultit të shokut Enver, intelektualët tanë ende i thurrien elozhe liderëve të sotëm dhe nëshkruajnë peticione për mbështetjen e "Enverëve" të sotëm, adhurim ky ndaj pushtetit nga intelektualët- që moti i detektuar nga Orwell.

#### INTELEKTUALI KRITIKON, POR ASKUSH NUK E DËGJON

Andaj duken të kota thirrjet: "ku janë intelektualët", "pse heshtin intelektualët", e të ngjashme. Ata janë aty ku kanë qenë gjithnjë- por të eklipsuar nga pushteti. Biles, sot kritikant intelektualë vetëm sa legjitimojnë ekzistencën e një kuazi-demokracie, me të cilën pushteti pastaj krenohet se "në shoqëritë tona, ekziston mendimi i lirë, ku secili mund ta kritikojë pushtetin!"

Paradoksalisht, erdhëm në situatën: sa më shumë kritikë intelektuale, aq më i fuqishëm pushteti. Sa më tepër "intelektualizëm" verbal, aq më tepër pushtet real. Nuk mbaj mend, që intelektualët ndërriuan regjimet në Ballkan; por vetëm matematikat e aleancave befasuese ndër-partiake.

Si rrjedhojë, shoqëritë tona mbeten fasada të demokracisë. Janë demokracia, ku intelektual i kritikon, por askush nuk e dëgjon.

Mësimi nga revolucionit borgjez francez edhe pas dy shekujve mbetet aktual për revolucionin post-komunist: "ka dy kategori njerëzish; ata që e bëjnë revolucionin dhe ata që përfitojnë nga revolucionin". Në shoqëritë tona "demokratike", intelektualët nuk i përkasin kategorisë së dytë.

Pushteti i butë post-komunist u dëshmuar shumë më efektiv në lodhjen dhe vetë-dorëzimin e intelektualëve, se ai i mëparshmi- i vrazhdi- komunist.

Intelektualët e pranuan këtë lojë, andaj as nuk mund të amnistohen. Ata, mbeten humbësit e vazhdueshëm, pa varësisht ndryshimit të sistemit.

Unë do të flas për dhunën, por jo me gjuhën e dhunës. E nuk do të ngre gishtin ndaj askujt, përveçse ndaj vetes sime. Dhuna e kohëve të fundit është vetëm shumatorja e arrogancës nëpër mikrofonin të rrjepur politikë, nga të gjitha palët që kanë në dorë ligje dhe nënligje, e që votën ia kemi dhënë, pasi e kemi shitur shpirtin me një pazar të turpshëm e të pakthyeshem. E atyre iu lumtë.

E shitëm, në shtrembërim të kombit, në shtrembërim të njerëzve, të moralit, të fëmijëve që na pasqyrojnë dhe të ardhmes së turbullt të këtij vendi që lyhet në fasadë dhe lëngon në brendësi. Dhuna fillon që në shtëpitë tona, kur bashkëshortët i thonë njëri-tjetrit "mbylle gojën" dhe fëmija dëgjon zërin e më "të fortit" prind dhe e përcjell të shokut i lagjes.

Dhuna vazhdon në rrugë, kur hakërrehemi nëpër makina e nëpër trotuare kush të kalojë më parë, sepse ngutemi për të qenë më të fortë dhe jo se kemi ndonjë punë të mirë apo fisnike për të bërë.

Dhuna zgjatet, kur djemve vazhdojnë t'ua mbajnë derën e

## Të pazanët ne

lokalit vajzat, sepse ata duhet të hynë me duar në xhepa e të tregojnë se katër fenerët e dritave të makinës i kanë marrë me vete edhe në tavolinë.

Dhuna stërzgjetet nëpër shkolla, nëpër kufij e prona, nëpër institucione shtetërore, ku qytetari i thjeshtë duhet të jetë i shenjtë e të trajtohet si i tillë.

Dhuna klith në indiferencën tonë ndaj atyre që pastrojnë—me aq sa munden—rrugët dhe ndërtesat publike, kokulur, sepse askush nga ne nuk ua ngre sytë t'u thotë "puna e mbarë".

Dhuna trashet kur mungojnë fjalët e falënderimit dhe të mirënjohjes te njerëzit kalimtarë apo jo të jetës sonë, sepse kemi filluar të kemi frikë nga mirësia e butësia dhe nuk ka kanosje më të madhe se kjo.

Dhuna jehon, sepse media të

Dhuna trashet kur mungojnë fjalët e falënderimit dhe të mirënjohjes te njerëzit kalimtarë apo jo të jetës sonë, sepse kemi filluar të kemi frikë nga mirësia e butësia dhe nuk ka kanosje më të madhe se kjo



vdes disa herë në emër të klikimeve, pa e kuptuar se bashkë me emrin e përfolur, vdes dhe ajo vetë. Titujt kryesorë u bëjnë lavazh pamor dhe mendor të gjitha moshave, duke e sjellë jetën e amullit publike në formën më të shëmtuar.

Gjuha mediatike vë në piedestal modele që nuk frymëzojnë,

por shigjetojnë me pahir, kthinat më të pazhvilluara të këtij vendi, me figura që vlerat nuk i njohin. Çdo ditë, duke çoroditur vajzat që kujtojnë se trupi i ekspozuar i bën më femra dhe djemtë që mendojnë se grushti i bën më burra. Dhuna do të trashëgohet në më të paktën tri breza, sepse 2.5 milionë shqiptarë — aq sa kanë mbetur — nuk janë në gjendje të bashkohen në një zemër të madhe, të kujdesen për veten, për tokën, për votën, për njëri-tjetrin dhe në 28 vjet kanë ndezur vetëm zjarrin e Kombëtares, sepse vetëm nga ajo ndihen të parrezikuar.

Të kemi frikë nga njëri-tjetri? Të mbrohemi nga njëri-tjetri? Nuk besoj se ka dhunë më të madhe, të përditshme dhe ngadalësisht më sflitëse se sa kjo.

Gishtin nga vetja, zemrën nga të gjithë.



Nga Arlinda Çausholli

## Elvana dhe elefanti që po na mbylLexime

Një ditë të bukur shtatori, brenda 3 orësh, nga 3 grupe njerëzish të ndryshëm, dëgjova emrin e një prej të plagosurve të incidentit të fundit në Bllok, nëpër biseda të ndryshme për katër histori të ndryshme plagosjeje, shërri publik, vrasjeje etj.

Puna dhe jeta, dhe shkollimi, dhe ambiciet e mia nuk kanë kurrfarë lidhjeje me kriminelët, por u çudita se si një njeri me precedent penalë dhe me kaq shumë dëshmi të njerëzve që kishin qëllyuar pranë tij në klube të ndryshme e restorante ku kishin ndodhur sherre me pasoja deri në vrasje, vazhdonte ecte i lirë dhe rrihte e plagoste në dritën e diellit në vende publike.

Ja ku isha unë që e diskutoja emrin e këtij kriminelini me një mikun tim, i cili ka pasion kulinarinë dhe një tjetër, i edukuar jashtë për arkitekturë dhe në atë moment, më erdhi keq kur kuptova se sado të përipiqem ta romantizoj Tiranën me ngjyrat e mia, qyteti në thelb vazhdon të ketë një mentalitet mesjetar, një Palermo në zhvillim e sipër, përderisa jo vetëm nuk dënojmë, por po promovojmë fuqizimin e kriminelëve dhe gjobëvënësve.

Por gjatë këtyre ditëve post-ngjarjes në Bllok, duke parë mënyrën se si u zbardh historia

dhe se si u mbulua nga mediat, kuptova që terrenin e veprimit të lirë të këtyre kriminelëve e kemi ndërtuar vetë. Thelbi i vrasjes në mes të Bllokut u anashkalua për hir të një telenovele më të klikueshme, asaj të pjesëmarrjes së artistes Elvana Gjata në vendndodhjen e konfliktit. Të gjitha mediat, qoftë edhe ato gjeneraliste u kthyen në rozë dhe Elvana në targetin më joshës për të thithur interesin e lexuesve.

Është mëse e kuptueshme që të raportohet e plotë një ngjarje nga mediat gjeneraliste dhe këtu nuk ka asnjë problem dhe asnjë detyrim për të mbrojtur/për të mbajtur të fshehur emrin e një të famshmi, kushdo qoftë ai/ajo.

Por eksitimi pervers për të ndërtuar çdo histori duke përfshirë këngëtarën, për të publikuar çdo lajm me foton e saj, analizat e shëmtuara për ta vendosur artisten në të njëjtin nivel me vajzat që shkojnë për lekë, në të njëjtat media që kanë publikuar prej më shumë se 15 vitesh sukseset e saj në muzikë; ngazëllimi diabolik i qindra njerëzve që komentonin dhe interpretonin në mënyrën më të neveritshme këngëtarën kaloi çdo limit, aq sa edhe zërat e atyre që kërkoni të përqendroheshin te thelbi i konfliktit dhe viktimat — të gjithë me precedentë penalë, të rrezikshëm dhe në kërkim, të cilët ecnin të lirë nëpër rrugët e

Tiranës — u mbytnë përballë tele-novelës.

Mediat nuk e kuptuan që duke u marrë intensivisht me pjesën rozë, historinë e Elvanës, shpëtuan pa dashje të rrezikshmit e vërtetë dhe u dhanë kriminelëve të pashkollë, mundësinë që të bëjnë atë që politikanët e studiojnë me vite të tëra në librat e strategjive politike; të heqin vëmendjen nga vetja. Jo vetëm kaq, por ndërsa fotot e artistes nga klipi "Mike" shfaqeshin sekondë pas sekonde, shumë portale, edhe ato më opozitaret nuk kuptuan se po u bënin nder edhe atyre që duhet të mbajnë përgjegjësinë më të madhe për këtë terren të frikshëm që është krijuar në vend.

Mëkati i vetëm i Elvanës në të gjithë këtë histori është fama e saj. Asgjë tjetër në jetën e saj, artistja nuk ia detyron askujt, duke përfshirë këtu edhe zgjedhjet romantike — përderisa në asnjë moment nuk ka pretenduar të jetë dikush tjetër, nuk është përfshirë në asnjë diskutim publik dhe nuk ka ndarë asnjë histori intime që kur hyri në muzikë në moshën 15-vjeçare me asnjë media, e për më tepër nuk i është imponuar ndjekësve të saj me mburrje e rrëfime të paqena, por vetëm me punë.

Nuk e krijoi Elvana terrenin e kriminit, nuk i promovoi Elvana kriminelët, nuk e krijoi Elvana Gjata emrin falë një burri, kushdo qoftë

ai, nuk ia pagoi njeri miliona klikimet (mbi 50 milionë vetëm këtë verë) dhe dashurinë e njerëzve që kanë mbushur sheshet e klubet ku ajo ka qenë e pranishme dhe as nuk ia dhuroi njeri, por e meritoi, pagesën, ndër më të lartat në tregun muzikor shqiptar. (Kolegët dhe menaxheret e koncerteve e dinë fare mirë.)

E ndërkohë që të gjithë janë mësymur për të poshtëruar e për të ngulur edhe më shumë thikën padrejtësisht tek emri i saj, duke fantazuar për "Helena Troje" (analogji injorantësh), harrojnë se me apo pa një mashkull në krah, qoftë "në kërkim" apo duke larë enët në shtëpinë e saj, këngëtarja do t'ia dalë, se s'ka asnjë mëkat, përveçse ka bërë atë që ka dashur gjithmonë; të këndojë. Elvana është vetëm një lajm që nesër do të harrohet, siç janë harruar lajme vajzash të famshme e të pafajshme këtu apo në botë të gjendura në vendin e gabuar në momentin e gabuar.

Por ajo çfarë ndodhi në Bllok dhe ajo çfarë po ndodh çdo ditë me krimet në këtë vend dhe promovimin e pranimit e kriminelëve në çdo sektor nga politika e deri në mburrje kafeneshe e tekste të panumërta rrepi, është jeta jonë. E thënë me gjuhën e rrugës: "Jemi rëndë, jemi aq rëndë, sa na bezdis një kotele, kur elefanti në dhomë po na mbyl".



Nga Dalina Buzi



## KTHIMI I LIDERIT BERISHA, FITORE E MADHE PËR KOSOVËN

Shumë gjëra kanë ndërruar në përfaqësuesen e Kosovës në futboll prejse Valon Berisha është paraqitur për herë të fundit për të. Ai kishte udhëhequr mesfushën e Kosovës në fitoren 4:3 ndaj Letonisë në miqësoren e luajtur më 13 nëntor të vitit të kaluar në Mitrovicë. Kosova tashmë ka përzgjedhës të ri, ka nisur garat në një Ligë të re, është kthyer në shtëpi e po ashtu plot emra të rinj i janë bashkuar përfaqësueses. Por Berisha prapë pritet të jetë prej liderëve të Kosovës. Ai për herë të parë është përfshirë në listën e përzgjedhësit Bernard Challandes, që në krye të Kosovës është nga marsi.



## Bardhi i sjell fitoren Levantes

Shkup, 7 tetor - Enis Bardhi ka realizuar supergol në xhiron e tetë të La Ligës ndaj Getafes. Ylli i Levantes tregoi sërish talentin nga gjuajtjet e lira duke shënuar gol të mrekullueshëm. Bardhi hyri në ndeshje në minutën e 46, ndërsa golin e gjeti vetëm 15 minuta më pas. Bardhi pas ndeshjes është shprehur i lumtur për golin e shënuar dhe se më shumë është i lumtur për tre pikët e fituara. "Jam i lumtur për golin e parë në këtë sezon, por më tepër jam i gëzuar për pikët që morëm duke luajtur si mysafir një ndeshje të rëndë. Mendoj se kjo ishte një ndër ndeshjet më të rënda, e dimë se si Getafe luan me topa të gjatë. Në pjesën e parë mendoj që kishim pak probleme, dhe në pjesën e dytë e kishim më tepër topin dhe aty Getafe u ndal", ka thënë Enis Bardhi. Ai ka thënë se nuk ka pasur presion dhe se e ka ditur se herët ose vonë goli do të vinte. "Më e rëndësishmja është ekip që ndihet mirë, që ka ndjenja dhe që po punojmë mirë në fushë dhe kjo është e rëndësishme për mua. E dija se goli do të vjen dhe se nevojitej vetëm kohë. E vërteta është se jam i lumtur për tre pikët dhe që e tërë ekipi ka bërë punë të mirë dhe tani kemi dy javë për të punuar më tepër dhe për të vazhduar në mënyrën e njëjtë", ka shtuar më tej Bardhi.

## LIGA E PARË - PËRFUNDON ME BARAZIM DERBI TETOVAR

# UMIT KARAN E NIS ME BARAZIM TE SHKUPI

FC Shkupi regjistroi barazimin e tretë në këtë sezon, pasi që në "paqe" u mbyll takimi me Rabotniçkin në stadiumin në Çair pran rezultatit 1-1. Shkëndija është ndalur me barazim 2:2 në derbin lokal me Renovën

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 7 tetor - Të shtunën janë zhvilluar ndeshjet e javës së nëntë në Ligën e Parë të Maqedonisë në futboll me çka edhe u mbyll rrethi i parë i ndeshjeve. Ekipi i Shkupit nën drejtimin e trajnerit turk Umit Karan u ndal në barazim 1-1 kundër Rabotniçkit, që është barazimi i tretë në këtë sezon. Skuadra e Shkupit ishte edhe pse dominoi në këtë takim nuk arriti që të merr fitoren. Të parët në avantazh kaluan nikoqirët. Një krosim në zonë nga Rron Broja, u konvertua në gol, por kësaj radhe nga mbrojtësi mysafir, Dimitrovski, i cili në tentim që të evitohet rrezikun para Suhel Muharemit, dërgoi topin në rrjetën e vet. Në pjesën e dytë, mysafirët kaluan në sulm për të barazuar shifrat dhe tentimi i Todorovskit u ndal nga portieri Aleksovski. Dhe në aksionin e parë më konkret të pjesës së



dytë, Rabotniçki barazoi shifrat në 1:1. Herera asiston brenda zonë, ku Petkovski me lehtësi shënoi për 1:1. Pas këtij barazimi Shkupit radhitet e fundit në tabelë me vetëm 6 pikë të tubuara në nëntë javët e para. Shkëndija është ndalur me barazim 2:2 në derbin lokal me Renovën. Në një ndeshje me kthesa kuqezinjtë avansuan me anë të Ibraimit, Stojanovski për dy minuta përmbysi gjithçka, ndërsa një pikë siguroi Bejtullai. Takimi nisi me një penalti të humbur nga Ibraimi, ndërsa i njëjti futbollist në minutën e 22 sjell epërsi 1:0. Humbja e koncentrimin në fazën defanzive për disa minuta në start të pjesës së dytë u kushtoi shumë kuqezinjtë, pasi kundërshtari shënoi dy gola të shpejtë me anë të Vlatko Stojanovskit. Fillimisht pasi fitoi vetë penalti pas një

dueli me Bejtullain, sulmuesi i bardhekaltërve barazoi në 1:1, kurse me të nisur nga qendra i njëjti futbollist ndëshkoi gabimin e Musliut dhe realizoi për 1:2. Në kushte kur sulmuesit nuk arrinin të sjellin efekt, në skenë shfaqet mbrojtësi Egzon Bejtullai që me gol të mrekullueshëm dhjetë minuta para fundit barazon në 2:2. Deri në fund rezultuan të pasuksesshme tentimet për të gjetur golin e tretë, kështu që kuqezinjtë duhej të kënaqen me vetëm një pikë nga ky duel. Trajneri i Shkëndijës, Qatip Osmani ka pranuar se performansa e Shkëndijës nuk ishte mjaftueshëm e mirë për të shkuar më shumë se barazimi 2:2 përballë Renovës. "Tre ndeshje pa fitore është një situatë jo e mirë dhe ne duhet të reagojmë. Në takimin e sotëm patëm penalti,

patëm disa raste, në pauzë shkuam me epërsi 1:0. Në vazhdim pranuar shumë shpejt dy gola të lehtë dhe nuk arritëm të kthehemi ashtu si duhet. Ky rezultat tregon se Shkëndija është jashtë formës dhe nuk duhet të luajë kështu", deklaroi trajneri Qatip Osmani, i cili më pas shtoi: "E kam cekur edhe më parë se ndjehet një lodhje dhe tash evidentisht është se përveç rezultateve kemi krizë edhe në lojë. Sigurisht se përgjegjësia në këto raste shkon te trajneri dhe përgjegjësia për mungesën e rezultateve ndoshta fajtori më i madh jam unë", tha Osmani, që vijoi se është u munduar në të gjitha mënyrat për të nxjerrë skuadrën nga situata momentale. "Prej humbjes me Pobodën jam munduar të ndryshoj diçka edhe në sistem edhe në formacion, por si duket ndoshta ende nuk kam gjetur formulën e vërtetë. Kështu që me kalimin e kohës besoj se Shkëndija do të kthehet në nivelin e duhur të cilin të gjithë e dëshirojmë", përfundoi Qatip Osmani. Në përballjet tjera, ekipi Vardarit ka vazhduar me serinë e fitoreve në Ligën e Parë. Pas eliminimit nga Kupa e Maqedonisë nga Makedonija GJ.P, skuadra e Vardarit është kthyer tek fitoret kësaj herë duke mposhtur Akademija Pandevin me rezultat të thellë 3:0. Bellasica ka barazuar me Sileksin 1:1, Makedonija GJ.P në terren vendas ka fituar ndaj Pobodës me rezultat 1:0.

## Sulmohet trajneri Bylbyl Sokoli



Trajneri i Llapit, Bylbyl Sokoli, është sulmuar fizikisht nga tre persona para banesës së tij në krye-

qytet, pas humbjes ndaj Prishtinës. Bylbyl Sokoli nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka dhënë një prononcim rreth sulmit që i është bërë pas ndeshjes Prishtina-Llapi (2:1) në hyrje të banesës së tij në kryeqytet. Ai po vazhdon të trajtohet në Klinikën Emergjente. "Vet fakti që u lajmërova në telefon tregon se rasti nuk

është serioz dhe ju lutem të gjitha mediave që sonte te kemi konsideratë", ka thënë Sokoli. I pyetur se a e din se kush të ka sulmuar, Sokoli nuk ka dashur që të komentojë. Me këtë rast është duke u marrë edhe policia e Kosovës të cilët në një kanë konfirmuar se Sokoli është sulmuar fizikisht nga disa persona të panjohur dhe se

policia është duke e hetuar këtë rast. "Të shtunën rreth orës 20:30 e kemi pranuar informatën se ne rrugën Hajdar Dushi ne Prishtinë një person është sulmuar fizikisht nga disa persona të dyshuar. personi i sulmuar B.S është dërguar për tretman mjekësor ndërkohe që policia po merret me rastin", ka thënë Flora Ahmeti.

## Kombëtarja e paralajmëruar, Panucci dhe djemtë "kërcënohen" nga ylli i Izraelit

Shqipëria do të luajë ndaj Izraelit me datë 14 tetor në Tel Aviv. Një ndeshje mjaft e rëndësishme për mbarëvajtjen e grupit tonë në UEFA Nation League. Skuadra e Christian Panucci-t ka fituar kundër izraelitëve me rezultatin 1-0 dhe humbi 2-0 në Skoci. Sfidat e ardhshme pritet të jetë ndryshe nga vendat që "kërcënojnë" skuadrën tonë me yllin e

tyre, Moanes Dabour. Sulmuesi kryesor i kombëtares që luan dhe për Red Bull Salzburg-un në Austri. Ai ka shënuar vetëm një gol me Izraelin dhe shpreson të çlirohet ndaj Shqipërisë. 26-vjeçari shkon dhe më tej kur shprehet se do të fitojnë grupin, pasi duan të mposhtin Shqipërinë dhe Skocinë. "Koha për të shënuar dhe me Izraelin. Kam besim

se do të jem lojtari që mund të bëjë diferencën për kombëtaren time. Jam në formë të mirë dhe kam shënuar disa gola këtë sezon. Nuk kam luajtur prej dy vitesh me Izraelin, pasi kam patur disa probleme. Tani kemi një trajner të ri që më ka dhënë besim. Dua të ja kthej besimin në fushë. "Nuk duhet të bëjmë më gabime. Nëse duam të kuali-



fikohe mi duhet të fitojmë dy ndeshjet e radhës. Ne kishim disa shance për të shënuar ndaj Shqipërisë, por nuk ia dolëm. Shpresoj të luajmë në të njëjtën mënyrë

po të shënojmë disa gola. Skocia është skuadër shumë e mirë, por ne do të bëjmë më të mirën për të fituar", u shpreh ai për "Dailymail online".



## FORMULA 1

# HAMILTON I JASHTËZAKONSHËM EDHE NË SUZUKA, VETTEL "KO" PAS KONTAKTIT ME VERSTAPPEN



Lewis Hamilton është thjeshtë fenomenal. Anglezi i Mercedesit regjistroi fitoren e 9-të sezonale në Formula 1 pasi fitoi Çmimin e Madh të Japonisë dhe tashmë do të paraqitet në garën e radhës në Austin të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me mundësinë për të siguruar edhe matematikisht titullin kampion

Lewis Hamilton hedh edhe një hap tjetër drejt titullin kampion bote në Formula 1, pas triumfit që korri të dielën në garën e Çmimit të Madh të Japonisë, garë e cila u zhvilluar në pistën e Suzuka. Ky është sukcesi i nëntë sezonal për pilotin britanik të Mercedes, që tashmë shkon në 67 pikë avantazh karshi Sebastian Vettel në renditjen e përgjithshme, ndërkohë që kanë mbetur edhe 4 gara nga

fundi. Një triumf i merituar i Hamilton, që e dominoi garën nga xhiro e parë deri tek e fundit, duke mos e lëshuar asnjëherë kreun dhe duke përfutur nga gabimet e rivalëve të tij. I dyti u rendit piloti tjetër i Mercedes, Valtteri Bottas, ndërsa në podium u ngjiti edhe Max Verstappen me Red Bull, që u klasifikua në vendin e tretë. Një tjetër garë për t'u harruar kjo e Sebastian Vettel me Ferrari, që pas

një kontakti me Max Verstappen në xhiron e tetë, kur duelonin për vendin e tretë, humbet kontrollin e makinës së tij dhe përfundon në fund të garës. Piloti gjerman duelon deri në fund, por duhet të kënaqet me vendin e gjashtë. Dobët u paraqit edhe Kimi Raikkonen me makinën tjetër Ferrari, i pesti, ndërkohë që para dy makinave "kokëkuqe" u rendit edhe Ricciardo me Red Bull. Gara e radhës e Botë-

rorit të Formula 1 pas dy javësh në pistën e Austin, në Amerikë, por deri atëherë Lewis Hamilton shijon i qetë këtë avantazh të jashtëzakonshëm që ka karshi Vettel, me Ferrarin që gaboi sërish këtë fundjavë, në prova e garë. Tashmë për pilotin britanik titulli kampion është një formalitet, që ka mundësi të menaxhojë këtë avantazh të madh që ka karshi rivalëve.



## Vettel tërhiqet nga sfida për titull

I dëshpëruar dhe me një fytyrë ku nuk ka asnjë shenjë gëzimi, Sebastian Vettel ka folur për mediat pas garës së Japonisë në Formula 1, ku ai u rendit në vendin e gjashtë, një rezultat zhgënjyes për të dhe Ferrarin. Tashmë për të fitimi i titullit kampion me Ferrarin po kthehet në një tabu, pasi piloti gjerman është 67 pikë pas Hamilton në renditjen e përgjithshme. Britaniku i Mercedes bëri një garë të mirë, e komandoi atë dhe e meritoi suksesin. Këtë dominon të Hamilton e pranon edhe vetë Vettel, që thotë: "Lewis e meritoi, bëri një garë të mirë, e komandoi atë dhe fitoi. Unë u përpoqa të jepja maksimumin, e nisa mirë garën, por kontakti me Verstappen, që nuk më la shumë hapësira për ta parakaluar, shkatërroi gjithçka, pasi makina pësoi dëmtime", thotë Vettel. "Që në start i dhashë makinës në maksimum për ta fituar garën, por nuk mjaftoi. Atmosfera tashmë nuk është aspak e mirë, pasi 67 pikë janë shumë. Punojmë gjithë vitin dhe kur nuk vijmë rezultatet e dëshiruara është e vështirë për të gjithë. Nuk di ç'të them më, por ky nuk ishte rezultati i drejtë për ne, meritoni më shumë", tha Vettel.



## Kyrie Irving i premtos besnikëri Boston: Rinovim dhe titull

Basketbollisti Kyrie Irving, përmes një interviste televizive, ka konfirmuar se dëshiron të qëndrojë sa më gjatë me skuadrën e Boston Celtics, tek e cila u transferua një vit më parë. Ylli i NBA-së mund të jetë "free agent" (lojtar i lirë) verën e ardhshme, por ai ka deklaruar se dëshiron të rinovojë kontratën, duke qëndruar edhe vitin tjetër. "Kam biseduar me shokët e skuadrës, duke marrë mendimin e tyre se çfarë synojnë. Por edhe me drejtuesit e klubit kam diskutuar për të ardhmëm. Nëse duan që të fitojnë, atëherë do të më kenë gjatë këtu, pasi ideja ime është që të rinovoj kontratën me Celtics në fund të sezonit. Dua të fitoj titullin këtu", u shpreh Kyrie Irving.



## Titulli një formalitet, Marquez triumfon edhe në Tajlandë

Marc Marquez fitoi garën e Çmimit të Madh të Tajlandës në Moto GP, duke hedhur një tjetër hap drejt titullit kampion. Piloti spanjoll i Honda fitoi duelin me Andrea Dovizioso (Ducati), që u rendit i dyti, sfidë që dy pilotët e zhvilluan gjatë gjithë garës, e cila ishte e hapur deri në finish. Rikthehet Yamaha, që me dy pilotët e saj bëri një garë të mirë

dhe renditet në vendet 3-4, me Maverick Vinales që la pas shokun e tij të skuadrës Valentino Rossi (ky i fundit e udhëhoqi atë edhe për disa xhiro në fillim). Gara e zhvilluar në pistën e Buriram ishte e jashtëzakonshme, me emocione pafund, sidomos në 4 xhiron e fundit, ku herë kryeson Marquez e herë Dovizioso, që shkëmbejnë shpeshherë

vendet mes tyre në krye të renditjes. Dhe, ashtu sikurse u parashikua, gjithçka u vendos në kthesat e fundit, me spanjollin që parakalon italianin e Ducati, duke korrur suksesin e tetë sezonal dhe tashmë udhëheq me 77 pikë në renditje, me 4 gara nga fundi. I treti doli Vinales, që rikthen motirin Yamaha në podium pas 5 garash.

## Nadal: Nuk rikthehem në fushë nëse nuk jam në 100% të formës

Rafael Nadal nuk ka ndërmend të rikthehet në fushë në rast se nuk do të rikuperojë 100% nga dëmtimi që pësoi në grand slam të US Open, ku u tërhoq në gjysmëfinalen e turneut nju-jorkez, të luajtur një muaj më parë. Numri 1 në botë ka deklaruar se nuk do të luajë asnjë ndeshje në turnetë aziatikë edhe pse kjo mungesë në fushat me çement mund t'i kushtojë atij kreun. Tenisti spanjoll ndodhet në Majorka, ku dhe po vijon fazën rehabilituese, me shpresën që të jetë gati për turnetë e fundit që zhvillohen në Europë.

"Situata është më mirë krahasuar me dy javë më parë, por ende nuk jam gati. Nuk kam ndërmend të rrezikoj dhe të luaj në turnetë aziatikë nëse nuk jam 100% gati, pasi mund të dëmtohem sërish dhe të rrezikoj më shumë për karrierën time. Gjërat po shkojnë mirë, por në fushë do të rikthehem vetëm kur të je mi bindur se kam rikuperuar totalisht dhe nuk do të kem më dhimbje. Besoj se do të jem në turneun e Parisit dhe më pas do të luaj edhe në finalen e Championship, në Londër", u shpreh tenisti spanjoll Rafael Nadal.





# REAL MADRID MES KRIZËS SË ZEZË, RAMOS FLET PËR NDRYSHIMIN E TRAJNERIT

“Të ndryshojmë trajner? Janë të tjerë ata që marrin vendimet, por nuk e di se çfarë të mire mund të sjellë një ndryshim trajneri. Do të ishte një çmenduri. Ndonjëherë shërben, të tjera herë jo. Gjithsesi, nuk është diçka që varet nga futbollistët. Unë ju paralajmëroj, kushdo që e jep Real Madrid për të vdekur, e ka kuptuar vërtetë keq. Duhet durim”, ka deklaruar Ramos

Tjetër disfatë e Real Madrid, kësaj here e mbërritur në minutat shtesë, ndryshe nga ajo ndaj CSKA për Champions League, kur goli u pësua që në fillim të ndeshjes. Tashmë “Los Blancos” janë zhytur në krizën e zezë, madje duke prekur rekorde negative të pashijura prej më shumë se 3 dekadash, me golin që mungon prej katër ndeshjesh, po aq sa janë edhe takimet e pafituara nga galaktikët. Goli i fundit i



madrilenëve është ai i Asensio në ndeshjen ndaj Espanyol. Kapiteni i Real Madrid, Sergio Ramos gjen guximin për të folur për mediat mbi dy çështjet kryesore dhe më të nxehtat në kampin madrilen, rreziku i shkarkimit të trajnerit Lopetegui, dhe kriza e golave që korrespondon me largimin e Ronaldos nga “Los Blancos”. “Të ndryshojmë trajner? Janë të tjerë ata që marrin vendimet, por nuk e di se çfarë të mire mund të sjellë një ndryshim trajneri. Do të ishte një çmenduri.

Ndonjëherë shërben, të tjera herë jo. Gjithsesi, nuk është diçka që varet nga futbollistët. Unë ju paralajmëroj, kushdo që e jep Real Madrid për të vdekur, e ka kuptuar vërtetë keq. Duhet durim. Ne jemi të parët që jemi të tërbuar. Tani që nuk është më Cristiano Ronaldo, flitet shumë për atë. Por edhe kur ka qenë ai ka patur momente në të cilat kemi hasur probleme të shënonim gol. Goli do të rikthehet. Rezultatet të dridhin, sidomos kur humbet, por skuadra ka dëshirë

dhe ambicie për të fituar. Është në ADN tonë”, deklaroi Sergio Ramos, pas disfatës 1-0 ndaj Alaves. Skuadra e Julen Lopeteguit tani ka katër ndeshje radhazi pa shënuar gol në të gjithë kompeticionet, pasi nuk ka gjetur rrjetën edhe ndaj Sevillas, Atletico Madrid dhe CSKA Moscow. Pas pushimit të ndeshjeve ndërkombëtare, Los Blancos do të mundohen t’i japin fund thatësirës përpara portës teksa do të presin Levante-n në Bernabeu më 20 tetor.



## Kovac rrezikon shkarkimin

Trajneri i Bayern Munich, Niko Kovac, po lufton që tani për vendin e punës. Trajneri kroat e mori drejtimin e ekipit bavarez në verë, por pasi janë luajtur vetëm 11 ndeshje zyrtare pozitat e tij në “Allianz Arena” janë lëkundur seriozisht. Bayern u mposht 3-0 në shtëpi nga Borussia Monchengladbach, ditën e shtunë, dhe burime brenda klubit tregojnë se Uli Hoeness i ka vënë një ultimatum trajnerit Kovac, me “fantazmën” e të zakonshmit Jupp Heynckes që po shfaqet në skenë. Alassane Plea dhe Lars Stindl shënuan në 16 minutat e para për t’i dhënë avantazhin Borussia, ndërsa dy minuta para fundit të ndeshjes Patrick Hermann vulosi humbjen e ekipit të Kovac, të dytën radhazi pas asaj ndaj Hertha. Duke llogaritur edhe barazimet me Augsburg dhe Ajax, Bayern nuk fiton prej katër ndeshjesh dhe Kovac është në udhëkryq. Sipas “Bild”, drejtuesit e Bayern kanë dyshime të mëdha dhe Kovac ka nisur të luftojë për mbijetesë. “Unë i di mekanizmat, e di si funksionon futboli në Bundesliga dhe ambientin në Gjermani. Ne kemi luajtur shtatë ndeshje mirë dhe katër ndeshje jo mirë, por nuk më takon mua të flas për shkarkimin. Unë jam i bindur se mund të bëjmë mirë në këtë sezon dhe personalisht do të bëj më të mirën. Normalisht te Bayern duhet të fitosh gjithmonë”, tha ish-trajneri i Eintracht Frankfurt.



## Silva: Mund të kisha shkuar te United

Bernardo Silva kund të kishte qenë futbollist i skuadrës tjetër të ekipit të Manchester. Mesfushori i Manchester City ka deklaruar për “The Sun” që ka pasur një interesim të madh nga “djajtë” në vitin 2017, kur ai zgjodhi të shkonte nga Monaco te ekipi i Guardiola. “E dija që Manchester më donte. Atje kam mik një fizioterapist, Victor Lindelof dhe trajnerin Mourinho e njoh”, tha Silva. “Nuk kam pasur asnjë ofertë zyrtare nga United, por biseda paraprahe. Propozimi serioz i City më bëri të mos mendohesha dy herë dhe jam shumë i lumtur që e pranova”. Deri tani, futbollisti i kombëtares portugeze ka shënuar tetë gola në 42 ndeshje zyrtare me Manchester City.

## Jorginho zbulon një nga sekretet e Sarrit

I përkëdheluri i trajnerit? Jorginho ka ditur shumë shpejt t’i tregojë shokëve te Chelsea dhe shtypit në Angli se është i denjë për fanellën “blu”. Fama e të preferuarit të Maurizio Sarri ishte ajo që ndikoi te italo-braziliani për të zgjedhur londinezët para Manchester City. Rendimenti i tij ka qenë i shkëlqyer dhe është përshtatur menjëherë në futbollin anglez. Harmonia me shokët e ekipit ka qenë shumë e mirë që në fillim, ashtu si ka pranuar vetë Eden Hazard: “Jorginho nuk është i përkëdheluri i Sarrit. Unë e thërras në të tillë mënyrë sepse ata që dy qeshin me njëri-tjetrin, por e them diçka të tillë vetëm sepse e njoh dhe Jorginho është djalë i



mirë dhe futbollist i shkëlqyer. Bëj shaka, ai është mjeshtri i pasimeve dhe po luan shumë mirë në këtë periudhë.” Vetë Jorginho, në një intervistë të dhënë për “The Sun” ka shpjeguar disa veprime kurioze që Sarri, që i sheh si të lidhura me fatin, edhe gjatë stërvitjeve. “Më pëlqen gjithçka nga futboli anglez, — tha organizatori i kombëtares italiane. — Historia e secili prej stadiu-

meve të motivon deri në minutën e fundit. Mund të flasim deri nesër për skaramancinë e Sarri. Le të themi se ai refuzon të prek topin në stërvitje ose në ndeshje. Edhe nëse topi del aut në këmbët e tij ai nuk e prek, nuk e kthen kurrë në fushë. Ndoshta nuk i pëlqen të loja të ndalet dhe e ka si shenjë fati mos ta prekë topin. Ky është një nga sekretet e tij.”

## Ky rekord tregon se sa i madh është Juventus

Juventus është bërë vetëm skuadra e gjashtë që i fiton tetë ndeshjet e para të sezonit në Serie A. ‘Zonja e Vjetër’ ka arritur që ta barazojë rekordin e vetë, pasi katër herë më parë e kishin bërë të njëjtën gjë. Kjo është një ecuri që është arritur vetëm në pesë raste më parë, së fundmi nga Napoli sezonin e kaluar. Edhe Roma kishte


një fillim të përkryer në sezonin 2013/14, por të gjitha ekipet tjera që e kanë arritur këtë ishin të Juventusit. ‘Zonja e Vjetër’ e ka arritur këtë veçori në sezonet 1930-31, 1985-86, 2005-06 dhe në 2018-19. Nga ana tjetër, Juventus dhe Dortmundi, janë të vetmet skuadra që nuk kanë pësuar ende humbje në të gjitha garat evropiane.





# NURMAGOMEDOV I PAMPOSHTUR,

# MUND MCGREGOR DHE KONFIRMOHET KAMPION BOTE



Në Las Vegas feston një rus. Khabib Nurmagomedov fitoi duelin e vitit në artet marciale ndaj irlandezit Connor McGregor. Suksesi i 27-të në karrierë për luftëtarin nga Dagestani i cili bëri të tijin titullin e UFC falë një lëvizjeje mjeshtërore në raundin e 4

Khabib Nurmagomedov konfirmohet kampion bote në peshën e lehtë në artet marciale mikse pas fitores me "submission" në raundin e katërt ndaj Conor McGregor në eventin UFC-229 që u zhvillua në Las Vegas. Një duel i jashtëzakonshëm mes dy prej kampionëve dhe ikonave të këtij sporti, në një përballje në përgjithësi të dominuar nga rusi, që mbron titullin kampion të fituar në prill të këtij viti. Por ky duel vijoi edhe pas ndërhyrjes së gjyqtarit, që ndali sfidën në kafaz pas kapjes që rusi i bëri rivalit irlandez. Madje emocionet më të mëdha kjo sfidë i pati në sherrin e madh që u transferua jashtë kafazit nga Nurmagomedov, që pati një konflikt fizik me persona të tjerë menjëherë pas fitores. Kjo krijoi kaos në kafaz e jashtë saj, ku u përfshinë edhe stafet e dy sportistëve e forcat e rendit, që ndërhyrën për të qetësuar gjakrat, madje pati edhe goditje të dy sportistëve. Situata e tensionuar bëri që në fund të mos kishte asnjë ceremoni zyrtare për dorëzimin e gjerdanit për Nurmagomedov, që u shoqërua nga salla i rrethuar nga forcat e sigurisë dhe ato të policisë, ashtu sikurse edhe McGregor. Palët u përpoqën të sqarohen me presidentin e UFC-së, Dana White. Vetëm, pas disa minutash u dha vendimi për fitoren e Nurmagomedov, që korri suksesin e 27-të në artet marciale mikse, ku nuk ka ende asnjë humbje. Për sa i përket duelit, ai ishte i fortë edhe pse munguan goditjet e fuqishme, pasi strategjia e Nurmagomedov funksionoi më mirë, me kapje të shpeshta të McGregor. Madje shumica e raundit të parë ishte si një duel mundje, ndërkohë që në raundin e dytë një e djathtë e rusit çoroditi irlandezin, që vetëm në raundin e tretë rivalizoi disi. Por Khabib nuk heq dorë nga strategjia e tij dhe pas një kapje në raundin e katërt arrin të detyrojë irlandezin të dorëzohet.

## MCGREGOR DHE KHABIB LIROHEN NGA POLICIA

Khabib Nurmagomedov nuk do të arrestohet nga policia amerikane. Rusi pasi triumfoi brenda oktagonit ndaj Conor McGregorit, u gjuajt në turmë duke sulmuar edhe ekipin e irlandezit. Në anën tjetër ekipi i Khabibit u fut në oktagon për ta sulmuar Conorin. Nga policia amerikane kishte të arrestuar nga të dyja palët por në fund aktorët kryesorë janë liruar. Por Conor nuk ka pranuar të ngre padi në polici, pasi ka preferuar që t'i zgjidhë

të gjitha vet me rusin. Këtë gjë e ka konfirmuar për mediat presidenti i UFC, Dana White. "Ata tanimë janë liruar nga policia, pasi McGregor ka refuzuar të ngrejë një padi", tha White. Ndërkohë tre anëtarët e ekipit të Khabib që sulmuan McGregorin janë arrestuar. Sipas medieve amerikane 30-vjeçari irlandez po dëshiron që të gjitha t'i zgjidhë vet me rusin Khabib Nurmagomedov.

## KHABIB: CONORI TREGOI MOS RESPEKT PËR FENË DHE FAMILJEN TIME, PUTINI MË UROI FITOREN

Khabib Nurmagomedov arriti të mbrojë titullin e peshave të lehta në UFC ndaj Conor McGregorit. Por, nata që ishte e destinuar të mbetej e paharruar për të mirë në T-Mobile Arena në Las Vegas, përfundoi në një kaos të vërtetë. Khabib pas fitores për një moment u tradhtua nga nervat dhe kaloi mburojat e oktagonit dhe filloi të përleshet me skuadrën e Conorit, gjë që në fund prodhoi një rrahje masive mes dy palëve. Pas



gjithë kësaj ndërhyrja e policisë dhe e sigurimit ishte e nevojshme, për gjithë këtë foli rusi në konferencën për media, por nuk pranoi pyetje nga gazetarët: "Së pari dua të kërkoj falje, kjo nuk është ana ime më e mirë.

Nuk e kuptoj se si njerëzit flasin se si kalova oktagonin. Ai foli për fenë dhe familjen time, vendin dhe babin tim, ai erdhi në Broklin dhe bëri probleme te autobusi, gati sa nuk vrau disa persona. MMA është sporti i respek-

tueshëm, nuk duhet folur budallallëqe", tha 30 vjeçari, duke kritikuar edhe pak mediat për devijimin e këtij sporti. E di që babai do të më qortoj kur të shkoj në shtëpi. Nevada, Vegas ju kërkoj falje. Ju faleminderit të gjithëve. Edhe... jam shumë krenar, të gjithë mediat kanë folur për një fotografi të tij (Conorit) me Putin, por Putin më thirri dhe është shumë krenar me mua dhe më uroi fitoren", shtoi për fund Khabib. Pra, Khabib i kërkoj falje të gjithëve, por Conorit dhe skuadrës së tij dhe me siguri është i vetëdijshëm që e pret një dënim i rënd për përleshjen e shkaktuar.

## MCGREGOR NUK DORËZOHET, KËRKON REVANSHIN NDAJ KHABIB

Përmes një mesazhi të shkurtër në faqen e tij zyrtare në "Twitter", Conor McGregor ka deklaruar se do të kërkojë revanshin e duelit ndaj Khabib Nurmagomedov, pas humbjes që pësoi me "submission" në raundin e katërt në eventin UFC-229, zhvilluar sot në Las Vegas. Taktika e rusit, që mbrojti titullin kampion bote të peshës së mesme, duke hedhur disa herë të tapet rivalin irlandez, përmes aftësive të tij në mundje bënë diferencën në këtë duel të madh, që dhuroi spektakël edhe pasi përfundoi, në sherrin masiv që përfshiu stafet e tyre dhe fansat. Vështirë të parashikosh nëse do të jetë një revansh mes dy sportistëve pas incidentit të mndodhur, duke qenë se tashmë Komisioni i Sportit në Nevada ka nisur një hetim për atë që ka ndodhur pas duelit. Për momentin Khabib i është pezulluar shpërblimi prej 2 milionë dollarësh vendosur nga UFC-ja, por masat mund të jenë edhe më të ashpra, deri në heqjen e titullit, duke qenë se anëtarë të stafit të tij goditën pas shpine me grushte irlandezin. Për momentin, situata është ende e mjegullt për sa i përket të ardhmes së dy sportistëve, por McGregor ka lëshuar sfidën për revansh.

## PRESIDENTI I UFC-SË, WHITE: KJO NUK KA TË BËJË ME SPORTIN, JAM I ZHGËNJYER

Kreu u UFC-së, Dana White, nuk e ka fshehur zhgënjimin e tij pas incidenteve që ndodhën pas meçit ndërmjet Khabib Nurmagomedovit dhe Conor McGregorit. Rusi i pamposhtur fitoi ndaj ish-kampionit në duelin e zhvilluar në kuadër të UFC 229 në Las Vegas. Mirëpo, të gjithë vëmendjen e morën incidentet pas përballjes mes tyre. Khabib i sulmoi anëtarët e ekipit të irlandezit, ndërkohë që edhe pjesëtarët e ekipit të tij e sulmuan McGegorin. "Është një natë e keqe

për mua dhe për njerëzit që i kanë mbuluar ngjarjet. E dimë se kjo nuk ka të bëjë me sportin. Tash për tash nuk jam në disponim të mirë. Jam i zhgënjyer. Jam njëri prej atyre që kanë punuar për 18 vite për ta sjellë këtë sport këtu ku është sot. Është diçka shumë personale për mua. Kam punuar aq shumë për një kohë shumë të gjatë. Është tejet zhgënjyese. Duhej të përfundonte me Khabibin duke dalë si kampion, por nuk ndodhi kështu", ka thënë White pas duelit.

## KHABIBIT MUND T'I MERRET TITULLI PËR SHKAK TË PËRFSHIRJES NË INCIDENTET E DHUNSHME

Shefi i UFC-së, Dana White, nuk e ka hedhur poshtë mundësinë që Khabib Nurmagomedovit t'i merret titulli i kampionit në kategorinë e peshave të lehta, për shkak të ndikimit të tij në përleshjen që pasoi pas duelit kundër Conor McGregorit në UFC 229 në Las Vegas. Triumfi i Nurmagomedovit në raundin e katërt u la në hije nga skenat e shëmtuara, pasi rusi sulmoi anëtarët e ekipit të irlandezit. Edhe pjesëtarët e ekipit të Khabibit hynë në 'Tetëkëndësh' duke e sulmuar Conor McGregorin. Duke i komentuar këto ngjarje, White

nuk e ka hedhur poshtë mundësinë që kampionit t'i merret titulli. "Nuk është qind për qind (se do ta humbë titullin). Ne kemi rregullore nga komisioni shtetëror... Komisioni sportiv i Nevadas do të jetë shumë i vështirë (në raport me Khabib). Guvernatori (i Nevadas) ishte këtu, ai u largua duke vrapuar nëpër ndërtesë, kjo nuk është aspak e mirë, ai (Khabib) është në telashe", ka thënë White pas meçit. Më pas, kreu i UFC-së ka theksuar se rusi i pamposhtur mund të suspendohet nga autoritetet e Nevadas dhe pastaj t'i merret titulli.















Qeveria përmes vendimit të kundërligjshëm, ka miratuar Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit dhe ka urdhëruar zbatimin e saj, pa u miratuar nga Kuvendi, dhe të njëjtin vendim e ka dërguar në Kuvendin e Kosovës.

# ZBULOHEK NJË VENDIM I KUNDRALIGJSHËM NGA HARADINAJ



Pushteti ekzekutiv – Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon trendin e marrjes së vendimeve të kundërligjshme, duke marrë në këtë mënyrë kompetencat dhe përgjegjësitë e një pushteti tjetër – Kuvendit të Kosovës. Luftimi i korrupsionit në Kosovë vazhdon të mbetet në letër në top agjendat e institucioneve shtetërore, por praktikisht institucionet e Kosovës nuk e kanë një Strategji Shtetërore dhe Plan të Veprimit për luftimin e korrupsionit. Kjo për arsye se Qeveria ka miratuar Strategjinë Shtetërore dhe ka urdhëruar zbatimin e saj, në vend se një gjë të tillë ta kalon për votim në Kuvendin e Kosovës, ashtu siç përcaktohet me ligj, transmeton Albeu.

Në përputhje me obligimet ligjore, Agjencia Kundër Korrupsionit, kishte dërguar në Qeverinë e Kosovës Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Planin e Veprimit, të cilat janë miratuar nga Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, përmes vendimit Nr. 02/37.

Vendimi i Qeverisë lidhur me miratimin e Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Plani i Veprimit kishte përcak-

tuar se vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, duke obliguar Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e vendimit.

IKD vlerëson se vendimi i Qeverisë bie në kundërshtim me mandatin dhe kompetencat e Qeverisë së Kosovës, duke marr kompetencat dhe përgjegjësitë që me ligj i takojnë Kuvendit të Kosovës. Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit në nenin 16 ka përcaktuar se Agjencia, në bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare harton Strategjinë Kundër Korrupsionit.

Agjencia përmes Qeverisë paraqet për miratim Strategjinë Kundër Korrupsionit në Kuvendin e Kosovës, dokument i cili përmban politikën kundër korrupsionit

që duhet të zbatohet nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Qeveria përmes vendimit të kundërligjshëm, ka miratuar Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit dhe ka urdhëruar zbatimin e saj, pa u miratuar nga Kuvendi, dhe të njëjtin vendim e ka dërguar në Kuvendin e Kosovës. Ky i fundit, përmes Komisionit për Legjislacion ka kthyer mbrapshtë vendimin e Qeverisë, duke vlerësuar se Qeveria ka zbatuar kompetencat të Kuvendit dhe ka kërkuar që vendimi të nxirret në përputhje me ligjin në Qeveri dhe më pas të dërgohet për miratim në Kuvendin e Kosovës.

Qeveria prej miratimit të këtij vendimi në mars 2018, ende nuk e ka dërguar në Kuvend vendimin e

ndryshuar në përputhje me ligjin për Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe rrjedhimisht Republika e Kosovës më shumë se gjashtë muaj nuk ka Strategji Shtetërore Kundër Korrupsionit.

IKD vlerëson se kjo situatë shkakton dëme të mëdha, duke pasur parasysh faktin se Strategjia Shtetërore Kundër Korrupsionit do të duhej të fillonte së zbatuari në vitin 2018, pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës, sipas procedurave të përcaktuara me ligj, ndërsa tani jemi pothuajse në fund të vitit 2018, dhe e njëjta Strategji ende nuk është proceduar në Kuvendin e Kosovës sipas obligimeve ligjore.

Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2018, kishte konstatuar se Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2018-2022

janë hartuar pas një procesi konsultativ, si dhe janë miratuar në mars të vitit 2018. Tutje, thuhet se Qeveria ende ka nevojë të demonstrojë lidhshmëri të vërtetë, aftësi për të praktikuar planifikim paraprak.

Qeveria e Kosovës duke mos proceduar këtë strategji sipas kërkesave ligjore në Kuvend është duke dëshmuar se e njëjta vazhdon me ushtrimin e kundërligjshëm të kompetencave dhe përgjegjësisë, duke i ushtruar kompetencat dhe përgjegjësi që i takojnë pushtetit legjislativ – Kuvendit të Kosovës, si dhe duke mos marr për bazë adresimin e konstatimeve dhe kërkesave të Bashkimit Evropian lidhur me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Një qasje e tillë e Qeverisë bie po ashtu në kundërshtim edhe me vullnetin dhe qëllimin e shprehur nga ana e Qeverisë përmes miratimit të te njëjtës për të pas qasje “zero tolerancë” ndaj korrupsionit, dhe për të vazhduar me parimet tjera siç është: Ndërtimi i integritetit, përgjegjësisë dhe transparencës në punën e organeve të administratës publike dhe forcimin i besimit të qytetarëve në institucionet publike; Përmirësimi i legjislacionit dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit; dhe Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë në fushën kundër-korrupsionit.

## BREGEDI SHQIPTAR, ÇAK I BLERËSVE TË HUAJ

Nuk janë vetëm të huajt që po blejnë në bregdet. Sipas agjencive kryesore të patundshmërisë në vend, një burim i kërkesës në bregdet kanë qenë shqiptarët e diasporës dhe shqiptarët e Kosovës, të cilët janë më shumë të fokusuar në Veri të vendit.

Të huajt vijojnë të mbajnë në lëvizje tregun e pasurive të paluajtshme në bregdet. Sipas agjencive kryesore në vend, arsyeja kryesore mbeten çmimet e lira, ndërsa blerësit kryesorë janë nga vendet e rajonit, të cilat nuk kanë dalje në det. Përmirësimi i infrastrukturës po tërheq blerës në Durrës. Fokusi i agjencive për bregdetin është kapja e tregjeve të huaja...

Në pamje të parë asgjë nuk i lidh një boshnjak, një italian, një ukrainas dhe dy gjermanë së bashku. Mirëpo që prej verës së këtij viti, ata janë banorët më të rinj të një prej pallateve në zonën e Shkëmbit të Kavajës në Durrës.



Çmimi për metër katror për një banesë matanë shinave të trenit në atë zonë varion nga 300 deri në 350 euro, gjë që ka joshur blerësit e huaj, të cilët sipas administratorit të pallatit kanë një moshë relativisht të re, nga 30 deri në 50 vjeç. Të gjitha shitjet janë kryer nëpërmjet agjencive të pasurive të paluajtshme dhe pronat kanë qenë të bllokua nga bankat.

Megjithatë nuk janë vetëm të

huajt që po blejnë në Durrës. Sipas agjencive kryesore të patundshmërisë në vend, një burim i kërkesës në bregdet kanë qenë shqiptarët e diasporës dhe shqiptarët e Kosovës, të cilët sipas Jonian Antonit nga agjencia Century 21 janë më shumë të fokusuar në Veri të vendit. Ndërsa për sa u përket shqiptarëve, Klajdi Memajdini nga agjencia Devinf, thotë se janë më kërkuar në cilësi dhe kërkojnë

kryesisht apartamente cilësore në rezidenca banimi.

Buxheti është një nga faktorët që ndikon në përcaktimin e zonës për individët që kërkojnë të blejnë në bregdet. Për familjet me një buxhet të kufizuar, Durrësi është zona kryesore, ndërsa familjet me të ardhura më të larta kërkojnë kryesisht në Jug dhe në përgjithësi investojnë për një pronë në komplekse rezidenciale. Shëngjini është zona ku ofertat janë më të ulëta, kurse Zona më e shtrënjtë për sa i përket çmimit të apartamenteve është Gjiri i Lalëzit, ku çmimi për metër katror varion nga 900- deri në 1100 euro për metër në katror, në varësi të kompleksit rezidencial ku ndodhet apartamenti.

Zona e dytë fillon nga Plepat deri në afërsi të Golemit. Në këtë zonë të Durrësit ka shumë ofertë për shitje, bazuar mbi pronat e listuara nga agjencitë kryesore të

pasurive të paluajtshme në vend. Çmimet më të ulëta janë për apartamentet në pallatet e ndërtruara pas hekurudhës, si në rastin në fjalë, që janë shitur me çmimin 300 euro për metër katror.

Zona e tretë është Golemi, Pishat e Buta dhe plazhi i Qerretit, ku çmimet për apartament janë rreth 800-850 euro për metër katror, duke qenë se rezidencat e banimit janë në komplekse dhe kanë lehtësi që tërheqin blerësit. Jugu i Shqipërisë mbetet zona më e shtrënjtë dhe jo vetëm për apartamentet, por edhe për vilat. Në Vlorë, zonat më të lira janë Rradhima dhe Orikumi. Sipas ofertave të listuara në Rradhimë, për një apartament banimi, çmimi mesatar është 700 euro për metër në katror, ndërsa në Orikum, çmimet mesatare për banesa janë rreth 450-500 euro/m<sup>2</sup>, në varësi të afërsisë me bregun e detit. /Monitor



“HARMONIA” PRO-RUSE FITON ZGJEDHJET

## BE “TREMBET” NGA PARADOKSI NË LETONI

Letonia ka një kufi me Rusinë dhe rreth një e katërta e popullsisë së saj prej 2.2 milionë është rusisht-folëse. Shteti Baltik është anëtar i NATO-s dhe BE-së duke e vënë atë në vijën e parë të marrëdhënieve gjithnjë e më të tensionuara midis Perëndimit dhe Moskës, ndërsa NATO ka më shumë se 1.000 trupa në vend.

Një parti pro-ruse ka fituar zgjedhjet e përgjithshme të së shtunës në Letoni. Partia “Harmonia” arriti 19% të votave, me partinë pro-BE “Për Zhvillimin” që e ndoqi me 12% dhe dy parti populiste, LV-në e KPV-së dhe Konservatorët e



Rinj që fituan 27% të votave së bashku.

Në të kaluarën, partitë kanë krijuar akte për të mbajtur “Harmoninë” jashtë qeverisë, por mediat shkruajnë se kjo parti tani mund të jetë në gjendje të formojë një qeveri nëse bashkon forcat me partitë populiste.

“Harmonia” do të mbajë 24 vende në parlamentin me 100 ven-

de, me Konservatorët e Rinj që kanë 16 dhe KPV-LV me 15, ndërsa shanset për një koalicion mes tyre janë rritur ndjeshëm.

“Asnjë kombinim i koalicionit nuk është i mundur pa Harmoninë që do të duket e aftë dhe e qëndrueshme”, tha për agjencinë e lajmeve Leta Nils Ushakovs, kryetari i Harmonisë dhe kryebashkiaku i kryeqytetit Riga.

Koalicioni qeverisës i Kryeministrit Maris Kucinskis që përbëhej nga Bashkimi i të Gjelbërve dhe Fermerëve, Aleanca Kombëtare dhe partia e Unitetit fituan vetëm 27%. Mbështetja e tyre u godit nga pakënaqësia publike në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave – të dyja çështjet kryesore të fushatës.

Letonia ka një kufi me Rusinë dhe rreth një e katërta e popullsisë së saj prej 2.2 milionë është rusisht-folëse. Shteti Baltik është anëtar i NATO-s dhe BE-së duke e vënë atë në vijën e parë të marrëdhënieve gjithnjë e më të tensionuara midis Perëndimit dhe Moskës, ndërsa NATO ka më shumë se 1.000 trupa në vend.

Ndërkohë, “Harmonia” ka thënë se dëshiron që Letonia të qëndrojë në BE dhe NATO, por që të ketë lidhje më të ngushta ekonomike me Rusinë.



### Presidenti i Interpol-it “merret në pyetje” në Kinë

Mes misterit rreth zhdukjes së kreut të Interpolit, ai është nën hetim në Kinë, kështu i ka thënë një burim South China Morning Post.

Meng Hongwei, 64 vjeç, i cili është gjithashtu zëvendësimistër i Sigurisë Publike të Kinës, u mor “për t’u marrë në pyetje” nga autoritetet e disiplinës sapo ai u ul në Kinë. Sipas burimit, nuk është ende e qartë pse Meng po hetohet ose saktësisht se ku po mbahet. Policia franceze ka nisur një kërkim për Meng gruaja e tij njoftoi ata se ai ishte zhdukur. Agjencia Ndërkombëtare e Policisë, INTERPOL thotë se i ka kërkuar informacione autoriteteve kineze për presidentin e kësaj agjencie, Meng Hongwei, i cili u raportua i zhdukur gjatë një udhëtimi në shtetin e tij të origjinës, Kinë. Në një deklaratë të lëshuar, INTERPOL thotë se “pret një përgjigje zyrtare nga autoritetet e Kinës për të adresuar shqetësimet rreth mirëqenies së presidentit”. INTERPOL po ashtu tha se ka përdorur kanalet e zbatimit të ligjit për të paraqitur kërkesën për informacione lidhur me statusin e Meng. Gruaja e Meng thotë se nuk ka dëgjuar asnjë lajm nga ai që prej se ai udhëtoi nga Lioni drejt Kinës në muajin shtator. Franca ka nisur një hetim për këtë rast. Autoritetet franceze thonë se presidenti i INTERPOL-it kishte udhëtuar me avion dhe avioni me të cilin ai po udhëtonte ka arritur në Kinë, por ende nuk di për vendndodhjen e 64-vjeçarit. Meng është gjithashtu zëvendësimistër i Sigurisë Publike në Kinë.



### Turqia ndërpret bashkëpunimin me kompaninë amerikane McKinsey

Presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan njoftoi të shtunën se kishte urdhëruar ministrat e tij të ndalonin marrjen e shërbimeve të konsulentëve nga firma amerikane McKinsey, pasi marrëveshja u vu nën akuzë nga opozita kryesore e vendit. Muajin e kaluar, Ministri i Financave, Berat Albajrak, i cili është gjithashtu dhëndër i Erdoganit, njoftoi se Turqia kishte vendosur të punonte me McKinsey si pjesë e përpjekjeve për të zbatuar një program të ri ekonomik afatmesëm. Kemal Kiliçdaroglu, kreu i Partisë Popullore Republikane Popullore (CHP), këtë javë akuzoi Erdogan se po punon me firmat amerikane, në një kohë kur marrëdhëniet me Uashingtonin janë tensionuar nga paraburgimi i një pastori evangjelist amerikan dhe çështje të tjera. “Ky person (Kiliçdaroglu) është duke u përpjekur të na akuzojë, duke u marrë me një firmë konsulente që është paguar plotësisht për të ndihmuar në menaxhimin tonë ekonomik”, tha Erdogan para anëtarëve të partisë së tij, në pushtet. “Me qëllim që të mos i jap atij atë shans, u thashë të gjithë ministrave të mi që të mos marrin më kështillime prej tyre (McKinsey)”, deklaroi Erdogan, ndërsa përfaqësuesit e kompanisë amerikane kanë refuzuar të komentojnë deri tani.

### Ankaraja nis hetimet për zhdukjen e gazetarisë saudite

Prokurorët në Turqi kanë nisur një hetim për zhdukjen e një gazetari saudit. Jamal Khashoggi, kritik i princit të kurorës së Arabisë Saudite, Mohammed bin Salman, nuk është parë që nga e marta, kur ai hyri në konsullatën saudite në Stamboll. Zyrtarët turq kanë thënë se besojnë se z. Khashoggi është ende brenda.

Princi bin Salman i tha Bloomberg Neës se autoritetet turke ishin të mirëseardhura për të kontrolluar ndërtesën. Mediat turke thanë se prokurorët tani po shikojnë nga afër çështjen, edhe pse veprimet ishin në vijimësi të hetimit të filluar të martën.

Reuters citoi partinë qeverisëse turke të thoshte se hetimi do të ishte gjithëpërfshirës dhe se ndjeshmëria e qeverisë për rastin ishte në “nivelin më të



lartë”.

Partia AK tha se vendndodhja e zotit Khashoggi do të zbulohet.

Kreu i Shoqatës së Medias Turko-Arabe tha për New York Times më parë se oficerët turq të sigurimit të konsullatës kishin kontrolluar kamerat e tyre të sigurisë dhe nuk e kishin parë gazetarin të largohej në këmbë. Por Turan Kislacki shtoi se maki-na diplomatike ishte parë duke lëvizur brenda dhe jashtë.

Të mërkurën, Ministria e Jashtme turke thirri ambasadorin e Arabisë Saudite dhe kërkoi një shpjegim për zhdukjen. Mark Lowen i BBC thotë se misteri kërcënon të thellojë tensionet në marrëdhëniet midis Turqisë dhe Arabisë Saudite. Turqia ka marrë anën e Katarit për bllokadën e saj nga Arabia Saudite dhe fqinjët e tjerë dhe afrimi i Turqisë me Iranin ka shqetësuar qeverinë në Riad, shton korrespondenti i BBC.

### EDINBURGU KUNDËR BREXIT

## Mijëra skocezë marshojnë për pavarësinë

Rrugët e Edinburgut u kthyen të shtunën në arenën e një demonstrate kundër Brexit, teksa skocezët mbushën rrugët dhe sheshet për t’i treguar Londrës zyrtare se dëshirojnë të qëndrojnë në BE. Mediat ndërkombëtare raportojnë se dhjetëra-mijëra skocezë marshuan për të kërkuar pavarësinë nga Britania e Madhe dhe pjesëmarrja e lartë është në kundërshtim me këmbënguljen e Londrës se nuk ka “oreks” për pavarësinë në Skoci.

Duke u nisur nga slogani “Të



gjitha nën një flamur”, fushata shpreson të bashkojë skandalet me vija të ndryshme politike për të avokuar për një referendum të

dytë mbi pavarësinë, pasi një votim i vitit 2014 u vendos me një diferencë të vogël votash në favor të pjesës që donte qëndrimin në

Mbretërinë e Bashkuar.

Vlerësimet nga protesta raportojnë për të paktën 100,000 njerëz që dolën të shprehin mbështetjen e tyre për një votim të dytë për pavarësinë skoceze.

Edhe moti doli në dukje në mbështetje të marshuesve, me lartësinë e qiellit blu që përputhej me atë të detit të flamujve skocezë më poshtë. Të tjerët lëshuan flamuj në solidaritet me lëvizjen e pavarësisë së Katalonjës, një Irlandë të bashkuar dhe BE-në.



Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160, 164-b të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-1751/2 të datës 15.02.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 0401-989/1 të datës 05.10.2018 nga UD Drejtori medicinal Doc. Dr. Spc. Ljazar Todoroviq, Drejtori organizativ M. Farm. Daniella Shapkarova e IPSH Klinikës universitare për kirurgji të fëmijëve – Shkup, publikon

### SHPALLJE PUBLIKE PËR PUNËSIM TË PUNËTORËVE SHËNDËTËSOR ME ARSIM SIPËROR DHE PUNËTORËVE SHËNDËTËSOR ME ARSIM TË MESËM

1. IPSH Klinikës universitare për kirurgji të fëmijëve – Shkup ka nevojë për punësim të:

1.1.1 (një) motër medicinale – **perfuzionist**

2. Kandidatët – punëtorë shëndetësorë duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për punësim të përcaktuara në nenin 158 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore edhe atë:

2.1 Kushtet e përgjithshme janë:

- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- të mos jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

2.2 Kushtet e posaçme që duhet t'i përmbushin kandidatët për

**Për kandidatin nën pikën 1.1**

- Arsim të mesëm të mbaruar të medicinës Arsim sipëror,
- provim të dhënë profesional,
- përvoja e punës së paku 6 muaj në departamentin për kardiologji të fëmijëve me trajtim intensiv.

- fletëparaqitje me të dhënat për kontakt

- biografi të shkurtë (CV)

- Dëshmi për Arsim të mesëm të mbaruar të medicinës (SHMM) për motër medicinale edhe atë Dëftesat e të gjitha 4 (katër) viteve në të cilat është theksuar që është arritur në SHMM për secilin vit veç e veç (original ose kopje të vërtetuar në noter) ose Diplomë për arsim sipëror të mbaruar me sukses mesatar (original ose kopje të vërtetuar në noter),

- dëshmi për provim të dhënë profesional (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- dëshmi për përvojën e punës (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore jo më të vjetër se 12 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- certifikatë të shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter).

4. Orari i punës është, 40 orë në javë.  
Për kandidatin nga pika 1.1 bruto pagesa është 28.551,00 denarë.

**Kandidatët të cilët kanë përfunduar arsim përkatës jashtë vendit duhet të posedojnë:**

- Diplomë të nostrifikuar me arsim përkatës
- Dokument për ekuivalencë të notave, të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

**Orari i punës është me ndërrime, 40 orë në javë, pagesa do të paguhet sipas marrëveshjes kolektive për shëndetësi.**

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.

7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e Komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.

8. Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur për doktorë të medicinës dhe për motër medicinale që i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

9. Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të parashtrihen deri në IPSH Klinikën universitare për kirurgji të fëmijëve – Shkup rr. Nëna Tereze nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinikës universitare për kirurgji të fëmijëve – Shkup, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Klinikës universitare për kirurgji të fëmijëve – Shkup

UD Drejtori medicinal  
Doc. Dr. Spc. Ljazar Todoroviq

Drejtori organizativ M. Farm.  
Daniella Shapkarova

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16) ndërsa në lidhje me Pëlqimin për punësim nga Ministria e Financave nr. 18-11713/2 nga 28.09.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 03-3749/1, datë 05.10.2018 nga u.d drejtori Drejtor i IPSH Spitali i përgjithshëm i qytetit "8-mi Septemvri" – Shkup shpall:

### SHPALLJE PUBLIKE

**Për punësim të 5 (pesë) doktorëve të medicinës – praktika e përgjithshme dhe 2 (dy) punëtorë të diplomuar social për kohë të pacaktuar të punës**

1. IPSH Spitali i përgjithshëm i qytetit "8-mi Septemvri" – Shkup ka nevojë për punësim për kohë të pacaktuar:

- 5 (pesë) doktorëve të medicinës – praktika e përgjithshme dhe
- 2 (dy) punëtorë të diplomuar social

2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:

- të jetë shtetas i RM-së,
- të jetë i rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- të mos ketë të shqiptuar ndalim ndalim efektiv për kryerjen e një profesioni, veprimtarie ose detyre.

3. Orari i punës është 40 orë në javë me ndërrime dhe **bruto pagesa** themelore:

- për vendin e punës doktor i medicinës është 38.380 denarë;
- për vendin e punës punëtor i diplomuar social është 34.039 denarë;

4. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët të cilët konkurrojnë për vendin e punës **doktor i medicinës – praktika e përgjithshme** duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- fletëparaqitja me të dhëna për kontakt dhe një **gjuhë ndërkombëtare për të cilën duhet të japë provim kandidati;**
- biografi të shkurtë (CV) me kontakt telefon dhe adresë banimi;
- Diplomë për arsim sipëror të mbaruar Fakulteti i mjekësisë me titull të arritur doktor i medicinës (original ose kopje të vërtetuar në noter) në të cilën do të ketë mesatare, ndërsa nëse nuk ka mesatare të parashtrijë Certifikatë të notave (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Licencë themelore për punë (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Verifikim të diplomës të marrë jashtë vendit me ekuivalencë të notave me mesatare (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 1 vjet (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë për njohje të gjuhës së huaj;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar vendim të plotfuqishëm gjyqësor kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 1 vit (original ose kopje të vërtetuar në noter).

5. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët të cilët konkurrojnë për vendin e punës **punëtor i diplomuar social** duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt;
- biografi të shkurtë (CV) me kontakt telefon dhe adresë banimi;
- Diplomë për arsim sipëror të mbaruar Fakulteti filozofik me mesatare ose Certifikatë të notave – Instituti për punë sociale dhe politike sociale (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Verifikim të diplomës të marrë jashtë vendit me ekuivalencë të notave me mesatare (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 1 vjet (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 1 vit (original ose kopje të vërtetuar në noter).

6. Nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatët për një vend pune zgjedhja do të bëhet në afat prej 45 ditëve, prej 201 deri në 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 90 ditëve dhe mbi 500 kandidatë për një vend pune zgjedhja do të realizohet në afat prej 120 ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

7. Afati për paraqitje të shpalljes publike është 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit.

8. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.

9. Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur për doktorë të medicinës – praktika e përgjithshme dhe punëtorëve social që i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

10. **Kandidatët të cilët do të paraqiten në shpalljen publike janë të obliguar të shënojnë se për cilën pikë të konkursit do të konkurrojnë.**

11. Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të parashtrihen në IPSH Spitalin i përgjithshëm i qytetit "8-mi Septemvri" – Shkup në rr. "Pariska" pn, përmes postës ose në arkivin e IPSH Spitali i përgjithshëm i qytetit "8-mi Septemvri" – Shkup, ndërsa me shenjë për Shpallje publike për punësim.

12. Fletëparaqitjet e dorëzuara përmes postës elektronike me dokumentacion jo të plotë të theksuara në konkurs nuk do të shqyrtohen.  
IPSH Spitali i përgjithshëm i qytetit "8-mi Septemvri" – Shkup

**FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË**

**SH P A L L J E**

**PASQYRË E AKSIONEVE NË PRONË TË FONDIT QË DO TË OFROHEN PËR SHITJE NË BURSËN E MAQEDONISË PËRMES ANKANDIT PUBLIK BURSAR NË TRE DITË RRESHT TË TREGËTIMIT, DUKE FILLUAR NGA 29.10.2018**

**SHITJA E AKSIONEVE PRIORITARE**

Numër rend.	Shoqëria aksionare	Vendi	Numri i aksioneve për shitje	Vlera nominale e shoqërisë në EURO	Vlera nominale e kapitalit për shitje (EURO)	Pjesëmarrja e kapitalit për shitje në vlerën e shoqërisë në %	Çmimi fillestar shitës i një aksioni në EURO
1	STELL-ER SHA Shtip	Shtip	12,892	534,348	65,878	12.33%	5.11

**Aksionet do të ofrohen për shitje përmes bursës së Maqedonisë në tre ditë rresht të tregëtimit duke filluar nga 29.10.2018. Shitja e aksioneve do të bëhet sipas modelit "të gjitha ose asgjë" me çka aksionet do të shiten në pako përmes një transaksioni. Pagesa do të bëhet në para të gatshme dhe në denarë sipas kursit të këmbimit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e shitjes.**

**FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË**  
www.piom.com.mk

**Republika e Maqedonisë**  
**MINISTRIA E SHOQËRISË INFORMATIKE DHE ADMINISTRATËS**  
**publikon Shpallje**  
**për grumbullimin e ofertave për qira për hapësirë afariste**

Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës publikon shpallje për grumbullimin e ofertave për qira të hapësirës afariste për qytetet në vijim: Shtip, Radovish, Kratovë dhe Dibër.

Hapësira afariste do të dedikohet për klub për internet falas dhe i njëjti duhet të përmbushë kushtet në vijim:

- *Hapësirë me sipërfaqe minimale prej 25m<sup>2</sup> dhe maksimale prej 45m<sup>2</sup>*
- *Rrjet të mirë elektrik dhe të ujësjellësit,*
- *Lidhje të mira sanitare me të gjitha kushtet,*
- *Mure të lyera mirë,*
- *Dysheme të mirë (pallaka, parket),*
- *Të ketë ngrohje të mirë gjatë dimrit dhe ftohje të mirë gjatë verës,*
- *Akomodim dhe radhitje të mirë,*
- *Lokacion i qashtëm deri në pjesën qendrore të qytetit në afërsi të të cilëve nuk ka internet klube private me çka do të kishte konkurrencë.*

Në ofertë duhet të theksohet:

- *Emri dhe mbiemri i juaj, adresa e banimit dhe numri i kontaktit;*
- *Të dhënat e lokacionit të hapësirës afariste dhe të gjitha kushtet e lartshënuara të dëshmuara me fotografi përkatëse nga pjesa e brendshme dhe e jashtme e hapësirës afariste;*
- *Dëshmi për pronësi të hapësirës afariste (listë pronësore) jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj; dhe*
- *shuma e gjashtë mujore të hapësirës afariste.*

Oferta e plotësuar me rregull t'i dorëzoni në adresën në vijim:

**Për Ministrinë e shoqërisë informatike dhe administratës - Bul. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë, me shenjë për - klube për internet falas.**

ose në formë elektronike në e-mail adresën: [radmila.pavlovska@mioa.gov.mk](mailto:radmila.pavlovska@mioa.gov.mk)

Ofertat duhet të dërgohen më së voni deri më 12.10.2018 deri në ora 12.00.

**MINISTRIA E SHOQËRISË INFORMATIKE DHE ADMINISTRATËS**

**Koha** <http://www.koha.mk>

**www.koha.mk**  
**koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk**  
**Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;**  
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, I Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015 dhe 27/2016), nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017) dhe nenit 2 alineja 2, nenit 3 paragrafi 1 dhe 2, nenit 21 paragrafi 3 nenit 22 alineja 2 paragrafi 3 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014) ndërsa në pajtim me Pëlqimin e marrë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së R. Maqedonisë nr. 12-10292/2 të datës 19.09.2018, Drejtori i SHFK "Nikolla Karev" – Krushevë publikon:

**SHPALLJE**

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në vijim për kohë të caktuar të punës për vitin shkollor 2018/2019 më së voni deri më 31.08.2019:

Për mësimin në gjuhën shqipe

**1. Mësimdhënës të mësimit klasor me orar të plotë të punës në SHFP Norovë**

Neto pagesa e paraparë për vendet e punës për mësimdhënës është 21.661 MKD për orar të plotë të punës.

Për mësimdhënësit orari ditor i punës është në pajtim me orarin e orëve, dhe do të realizohet me dy ndërrime, ndërrimi i parë dhe i dytë.

Kandidatët duhet të kenë të mbaruar arsimin përkatës në pajtim me dispozitat ligjore.

Kandidatët dokumentet e nevojshme ti dorëzojnë në adresën e shkollës SHFK "Nikolla Karev" – Krushevë në afat prej pesë ditëve nga publikimi i shpalljes. Vendimi për zgjedhje do të silltet në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Dokumentet e nevojshme:

1. Lutje
2. CV
3. Certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter.
4. Diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar, original ose kopje të vërtetuar në noter.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit, të pakompletuara dhe dokumentet me afat të kaluar nuk do të merren parasysh.

SHFK "Nikolla Karev" – Krushevë  
Drejtor  
Olivera Çavkarova



# NË TETOVË U MBAJT FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I FILMIT TIFF ODA



## Ja çmimet që u ndanë në këtë festival:

Kategoria – WIN PANORAMA (Filmat e shkurtër në konkurrim) Përbërja e jurisë:

1. MEVLAN Shanaj
2. BURBUQE BERISHA
3. LLAZAR SEKULOVSKI

### Filmi më i mirë

I've got you – Poloni

### Regjia më e mirë

Approachhing- Republika Ceke

### Montazhi më i mirë

Fight for death-Maqedoni

### Kinematografia më e mirë

Bon appétit-Shqiperi

### Filmi më i mirë i Animuar

Ethnophobia-Shqiperi-Greqi

### Çmimi i publikut

Toka-Maqedoni

### Kategoria: Student panorama

### Filmat Studentor në konkurrim:

#### Dokumentari më i mirë studentor

Students – FDU- Maqedoni

#### Filmi më i mirë Studentor

First Kiss-Fiofa

#### Çmim nderi

Man with the will of steel-

Bosnja dhe Hercegovina

Në Qendrën për Kulturë në Tetovë, prej 1-6 tetor, ishte organizuar edicioni i shtatë i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit TIFF ODA, i cili do të zgjasë deri të shtunën dhe çdo ditë do të shfaqen filma të metrazhit të shkurtër dhe ngjarje të tjera artistike-kutlurore.

Brenda këtij edicioni do të shfaqen filma nga vende dhe artistë të ndryshëm. Siç u njoftua në hapjen e festivalit TIFF ODA, nga gjithsej 3.843 filma që kanë

aplikuar nga e gjithë bota, në këtë edicion do të shfaqen 83 filma të shkurtër, të ndarë në tre kategori në garim, dokumentar i shkurtër, animacion i shkurtër dhe filmat e studentëve.

Festivali, i cili këtë vit organizohet për herë të shtatë, do nisi me filmin dokumentar kushtuar kampionit olimpiq në mundje Shaban Tërstena, ndërsa do të përfundojë të shtunën me një ekspozitë të fotografive, ku në ceremoninë e përmbylljes do të mar-

rin pjesë edhe ikonat e artit skenik shqiptar Tinka Kurti, Margarita Xhepa dhe Reshat Arbana.

Këtë edicion do të shfaqen edhe filmat evropian me karakter jo-garues "Cine European Panorama", ku ndër filma të shumtë evropianë do të shfaqen edhe filmat me arritje në majat e kinematografisë botërore të regjisorit dhe skenaristit iranian, Asghar Faradi, me dy filmat e tij të shpërblyer nga Akademia Oscar, "The Salesman" dhe "The Separation".

## LETRA E RRALLË E SELMAN RIZËS DËRGUAR TIM ATË DRITËRO

Nga Elona Agolli

Në morinë e dorëshkrimeve, letërkëmbimeve e dosjeve të shumta të tim eti, letërkëmbimi me prof. Selman Riza është më i veçanti.

Dallohet një respekt e miqësi e ndërsjelltë. Në bisedat familjare shpesh përmendej, po ashtu, albanologu dhe atdhetari i përveçëm prof. Riza.

Një letër e tij në kohën kur ishte larguar nga Instituti i

Gjuhësisë dhe shërbente në muzeun dhe bibliotekën e Beratit, dëshmon shumë më tepër se çdo dokument historik, mendjehaptësinë, kulturën e komunikimit, çiltërsinë dhe kurajon për të vijuar jetën e intelektualit të rrallë edhe në kushtet e vështira të jetesës në Berat, larg qendrës studimore albanologjike.

Letra e shkruar në vitin 1969, të befason me zhdërvjelltësinë e bukurinë e gjuhës. Në fakt ajo



përmban vëzhgime kritike gjuhësore e stilistike për poemën "Ba-

ballarët", botuar nga Dritëroi po atë vit:

"I dashamirësuar Dritëro Agolli,

Në poemën tuaj (jo) të fundit (brendinë e së cilës unë prozaikisht do ta përmblihdhja kështu: "vlerësim reciprok ekzaltues i dy brezave barabar heroikë"), përdorja alternative "baballarë(t)": "etrit tanë" mendoj se përbën një keqkuptim gjuhësor-stilistik, midis tjerash, për këto arsye:

- 1) Në letërsinë tonë fjala "baballarët" (psh. "të kombit") është përdorur më fort si pezhorative;
- 2) Në titullin dhe trupin e poemës, emri "baballarët" patjetër është më i pacaktuar, më indirekt dhe, si të thuash, më i ftohtë se togfjalëshi "etrit tanë";
- 3) Përdorje alternative të këtyre dy quajtjeve unë në trupin e poemës nuk i gjeta dot asnjë funksion diferencues të asnjë lloji;
- 4) Si kumbim, fjalës "baballarët" a nuk është për t'iu përpëlqyer togfjalëshi "etrit tanë"?
- 5) Si prejardhje, anadollakizmit kaba "baballarët" a nuk është gjithashtu për t'iu përpëlqyer lashtë-shqiptarizmi i zhdërvjelltë "etrit tanë"?

Mora këtë mundimth për të ju kumtuar këtë vërejtje në një sepse nga ribotimi i poemës suaj kaq të brumët si brendi e kaq të hovshëme si derdhje mund dhe duhet mënjanoar edhe ai më i lehti stonim stilistiko-gjuhësor, dy sepse desha të krijonj vehtes rastin për të ju shprehur dashamirësinë time dhe respektin tim.

12.6.1969

Selman Riza

Pranë Bibliotekës së Shtetit

Berat



## Lazarati në "Hollywood", 25 mijë fishekë për të xhiruar filmin "The Brave"

"The Brave" është filmi i frymëzuar nga ngjarjet e Lazaratit dhe që nga e premija po shfaqet në të gjitha kinematë e Tiranës dhe Prishtinës. I ftuar në emisionin "Zonë e Lire", producenti amerikan i filmit Joe Issa Zarau i shpreh se filmi sjell historinë e një oficeri të pakorruptuar të policie (Louis Mandylor, që ka luajtur te Big Fat Greek Wedding) në luftë kundër mafias së hashashit që ka pushtuar një fshat shqiptar. Në këtë film luajnë 3 aktorë të njohur shqiptarë, Bes Kallaku, Vin Bejlari dhe Mensur Safqiu. Në të luajnë aktorë të mëdhenj amerikanë si Armand Assante, por dhe 3 nga aktorët më të famshëm rusë, ndër ta edhe Ravshana Kurkova e Yuri Kutsenko, i cili sipas producentit Zarau, konsiderohet në Rusi në përmasat e Al Paçinos. Ai ka treguar se "25 mijë fishekë janë harxhuar për xhimin e skenës mbyllëse të filmit". Filmi me regji nga regjisor amerikan William Kaufman (që ka punuar dhe me Dolf Lundgreen dhe fituesin e çmimit Oskar, Cubs Gooding Junior) ka skena aksion me përmasa hollivudiane dhe në të duket përpjekja e forcave RENEA për të vënë nën kontrollin e ligjit fshatin që mbjell hashash e ku ka ngritur perandorinë e tij të drogës bosi amerikan i drogës, italo-amerikani Frank Pedulla (Armand Assante). E veçanta e filmit është që për të kanë investuar investitorë shqiptarë që sipas producentit Zarau, janë angazhuar në film me dëshirën e mirë për të dhënë imazhin e në Shqipëri tjetër, jo si ajo që portretizohet në filmin Taken. "Jo të tërë shqiptarët janë si tek "Taken", thotë Koloreto Cukali, bashkëproducenti shqiptar i filmit. "Ka një Shqipëri të bukur, dhe ka shqiptarë pozitivë. Këtë sjell ky film. Një Shqipëri të vërtetë, me problemet e veta, por dhe me heronjtë e vet." Filmi, i mbështetur nga "Digitalb", do të ketë premierën në Rusi pas një jave, dhe më pas do shfaqet në mbi 4 mijë kinema të e atij vendi, sipas producentit Zarau.



**DASHI** 21. mars - 20. prill  
Mund të ketë më në fund të reja të rëndësishme për karrierën tuaj aktuale. Jini të gatshëm për të çuar përpara propozime të cilat do ju lejojnë që të bëni përparime të ndjeshme në vendin e punës. Këshillohet që të tregoni më shumë kujdes për shëndetin.

**DEMI** 21. prill - 21. maj  
Pritet të ketë të reja të rëndësishme, të cilat do ju lejojnë që të ecni përpara me projektet dhe aktivitetet tuaja. Edhe në dashuri kjo do të jetë një periudhë mjaft e frytshme, ndaj mos jini të ndrojtur.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor  
Rishikoni më mirë vendimet tuaja të së kaluarës, për të përpunuar strategji të reja lidhur me të ardhmen. Do të keni një intuitë shumë të mirë, por duhet të mundoheni të mos lini pas dore anën më strategjike të projekteve tuaja. Përgatituni që të përballeni me debate të vogla në lidhjen në çift.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik  
Kjo është një periudhë shumë e mirë për të analizuar të gjithë projektet e kohëve të fundit. Do të jeni shumë të lodhur dhe për këtë arsye duhet ti organizoni gjërat më së miri, pasi keni nevojë për të pushuar. Shmangni angazhimet e tepërta.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht  
Në këtë moment duhet të mendoni më shumë për veten dhe nevojat tuaja kryesore. E keni lënë veten shumë pas dore dhe për këtë arsye duhet ti kushtoni më shumë vëmendje. Në vendin e punës, parashikohen konfirmime të rëndësishme.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator  
Mundohuni të mos përfshiheni në çështje që nuk ju interesojë, sidomos nëse gjatë ditëve të fundit jeni ndër të ndjerë shumë të lodhur. Ky është një moment shumë i mirë për të rikuperuar energjitë dhe për të pasur më shumë dëshirë për të bërë gjëra. Megjithatë duhet të çliroheni nga gjithë ato situata që mund t'iu vendosin në siklet.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor  
Kjo është një periudhë shumë e rëndësishme, për të bërë ndryshime themelore në stilin tuaj të jetës. Shmangni ndjekjen e së njëjtës rutinë dhe mundohuni të përfshiheni në nisma të reja. Në dashuri do të jeni mjaft të përkushtuar dhe pasionant.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor  
Mundohuni të jeni më racional dhe shmangni joshjen nga persona shumë tendencioz ndaj jush, pasi në këtë moment keni nevojë për më shumë qartësi, sidomos në dashuri. Në vendin e punës parashikohen zhvillime mjaft të rëndësishme.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor  
Kjo e diel do të jetë mjaft e favorshme për takime, sidomos nëse gjatë ditëve të fundit jeni ndër të nënvlerësuar. Këshillohet që në vendin e punës të jeni më të përqendruar, pasi një zgjidhje shumë e nxituar, mund t'iu dëmtojë.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar  
Do të jeni shumë më kurajoz dhe të vendosur në vendin e punës. Këshillohet që të veproni me diplomaci në mënyrë që të arrihi objektivat tuaja pa shpenzuar shumë kohë dhe energji.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt  
Në këtë moment keni nevojë për të gjetur disa aspektet të jetës tuaj, të cilat mendoni se i kishit harruar prej kohësh. Një takim interesant mund të rizgjojë emocionet tuaja.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars  
Mundohuni që ta lini mbrëmjen e lirë, në mënyrë që të dilni dhe të kënaqni veten. Duhet të relaksoheni më shumë dhe ti jepni vetes më shumë kohë për të qenë në paqe me partnerin/en dhe familjen. Kjo e diel favorizon arratisjet e vogla romantike.

Mensur Mamuti	SPORTISTE QË MERRTË ME ATLETIKË	FITORE ME SHUMË SAKRIFICA, E NJOHUR SIPAS PRIJESIT NË FOTO	ALBUM I ADELINA ISMAILIT	NOFKA E GJENERALIT GREK NË FOTO	EMRI ORIGINAL I IRLANDE
FLETË NJOFTIMI PËR NJË SHFAQJE, FILM APO NJË NGJARJE TJETER					
PANTALLONA PREJ SHAJAKU (SH.)					
YLLI I NDRITSHËM I KONSTELACIONIT SHQIPONJIA					
<b>A</b>					
ELEKTRO - OPTIK			PEJA I BËRË PREJARI		
GRUP PREJ TRE KENGETARËSH					PJESË E KONTINENTIT ME TË MADH (PASHQ.)
BANORË E NJË QYTETI KOSOVAR					
<b>P</b>					
<b>KOHA</b>	GRERËZ QËNDRIMI PARIMO				
GRUPI ANGLEZ, SHOP BOJS				ITALIA QYTET NË ITALI	
MBËRTHYESE LETRASH					
<b>K</b>					
RIMINI			LLOJ KADHE, KIZA		
MBRETI GREK NË FOTO, I BIRI I AKILIT			BANOR I QYTETIT GUATEMALAN, OLOPA		
<b>P</b>					
PRIJESI NË FOTO, PËRVEÇ EPIRIT ISHTE MBRET EDHE I NJË FISË GREK					
PËREM, TË KËTILLË					
<b>K</b>				1000 ROMAK SHKRIMTARJA GJERMANE, BRANDT	TEMPERTURA EMRI I NOLIT
SUEDIA	PARAPËLQEN MOLIBDENI				POSEDON JEVG
NJË PROFET (KRISHTI)				KËNGËTARI DHE AKTORI FRËNG, MARSEL	SPANJA
MOSPJESËMARRJA NË NJË PUNË, SHMANGIE					ZERO



ZGJIDHJET: AFISHE, TIRQI, ALTAIR, EO, PE, TRIO, PEJANJA, ARËZ, PET, I, KAPËSE, RI, KMSA, O, PIRRO I EPIRIT, MOLOSË, R, KËSO, M, T, KA, S, PREFERON, ISAU, AMONT, ABSTENIM, O.


**Shumë i lehtë** **Sudoku** **mesatar**

2			8	6				5		6		1	4			9
	4	9		5		3	8				7			6	2	
	5		3				7			4	3			2	6	5
			4		5	6		7		3	4					5
9	2						3	8	7							9
7		5	9		8				1						8	7
	1				2		6			2	1	8			5	4
	7	6		8		2	5				9	5			3	
5				7	3			4		5			2	7		1

Shumë i lehtë: 237861945, 149257386, 658394172, 381425697, 924716538, 765938421, 813542769, 476189253, 592673814. Mesatar: 562148793, 917356284, 843972651, 234789165, 786215439, 195634872, 621893547, 479561328, 358427916.



# ASTRONOMËT ZBULOJNË SATELIT JASHTË SISTEMIT DIELLOR



Astronomët kanë zbuluar një satelit përtej sistemit diellor. Hulumtues nga Universiteti Columbia në SHBA njoftuan se pas vëzhgimeve që kanë bërë me teleskopin Kepler të NASA-s dhe më pas me teleskopin Hubble, kanë zbuluar një satelit jashtë sistemit diellor me përmasa të

Neptunit apo Uranit, që gjendet tetë mijë vite drite larg nga toka.

Astronomët David Kipping dhe Alex Teachey, duke folur në lidhje me zbulimin, thanë se mendohet që sateliti i zbuluar jashtë sistemit diellor të jetë sateliti i planetit Kepler-1625b të zbuluar më herët. Kipping

dhe Teachey paralajmëruan se do të zhvillojnë edhe më shumë punime për ta kuptuar sistemin planetar jashtë sistemit diellor. Detajet e zbulimit janë publikuar në revistën "Science Advances". Deri më tani, astronomët kanë zbuluar mbi 3,500 planete jashtë sistemit diellor.



## Galaxy Note 9 lë mbrapa edhe iPhone e rinj

Gjenerata e re e telefonave të Apple-it, iPhone XS dhe XS Max është më e mirë në çdo aspekt në krahasim me gjeneratën e shkuar, iPhone X, megjithatë mbetet prapa telefonit të Samsungut, Galaxy Note 9. Ky është konkludimi që ka nxjerrë revista prestigjioze amerikane "Consumer Reports" që merret me testimet e produkteve që iu interesojnë konsumatorëve, por edhe me hulumtime tjera. Kjo revistë publikohet që nga viti 1936.

Rezultati i testeve është se gjenerata e re e iPhoneve është më e mirë se e shkuara për bateri, performancë të kamerës dhe në çdo performancë tjetër. "CR" ka konkluduar se iPhone XS dhe XS Max kanë bateri më të fuqishme dhe navigim shumë më të shpejtë e të lehtë.

Megjithatë, qëndrueshmëria mbetet problemi kryesor për blerësit e iPhoneve. Në këtë pikë, Samsungu mposht Apple-in, me Galaxy Note 9, dhe për këtë arsye gjenerata e re e iPhoneve nuk është "Numri 1" në botën e telefonave.

## Hyjnë në dyqan për të vjedhur marijuanë, por ishte rigo



Dy adoleshentë vodhën një dyqan marijuanë dhe nga nxitimi morën gjithçka që ndodhej pas banakut. Ata nuk mund ta imagjinonin se bima e ekspozuar nuk ishte gjë tjetër veçse rigo. Sipas asaj që raportohet nga mediat lokale, incidenti ka ndodhur disa ditë më parë brenda Native Roots, në një dyqan në Colorado Springs të SHBA-së. Djemtë vendosën të vidhnin marijuanën jo për shkak të pamundësive ekonomike, por për shkak të moshës së tyre të vogël që ligji nuk i dënon për shitjen e drogave të lehta. Por vjedhja duhet të ketë qenë një sur-

prizë e keqe: sepse brenda enëve tashmë të përgatitura kishte rigo sepse rreth banakut ka vetëm produkte të ekspozimit, ndërsa marijuana është ruajtur në pjesën e prapme e dyqanit, në një dhomë praktikisht të blinduar. Që kur marijuana, është bërë e ligjshme në shumicën e Shteteve të Bashkuara, ekonomia ka patur një rezultat pozitiv dhe një lloj biznesi i ri është zhvilluar. Në Kolorado, për shembull, legalizimi i marijuanës ka lejuar ngritjen e shumë kompanive të reja dhe dyqaneve të mëdha, të aftë për të gjeneruar fitime të shkëlqyera.

## Shkoda e parë SUV elektrike arrin më 2020



Prodhuesi çek njoftoi lansimin e makinës së parë të tij plotësisht elektrike në dy modele të ndryshme në vitin 2020. Vetura e parë elektrike e Shkodës bazohet në konceptin Vision E dhe platformën e re MEB të Volkswagen. Shkoda planifikon të ofrojë dy variante - praktike dhe të orientuara në stil, dhe e para që do të mbërrijë do të jetë me madhësi të mesme si Kodiaq, me të gjitha avantazhet e makinës elektrike. Prodhuesi çek mund të

prezantojë dy koncepte të ndryshme vitin e ardhshëm si një hyrje në një model prodhimi që do të zbulohet në gjysmën e parë të 2020. Kjo është një strategji që VW përdor me I.D elektrike të saj.

Gjithashtu, Shkoda ka konfirmuar se modeli i saj i parë i bazuar në platformën MEB do të jetë më i madh se makinat e njoftuara nga VW dhe SEAT, të cilat pritet të jenë një hatchback me pesë dyer.



KALENDARI HISTORIK 8 TETOR

1075 - Dimitar Zvonimir kurorëzohet mbret i Kroacisë.

1600 - San Marino miraton kushtetutën.

1690 - Trupat turke okupojnë Beogradin.

1912 - Fillon Lufta e I Ballkanike - Mali i Zi shpall luftë Turqisë.

1939 - Gjermania përvetëson Poloninë Perëndimore.

1940 - Trupat gjerman okupojnë Rumaninë.

1952 - Sulmet kineze drejt Koresë.

1962 - Algeria pranohet si anëtare e OKB.

1967 - Udhëheqësi i guerilëve Che Guevara dhe njerëzit e tij zihen në Bolivi.

1971 - John Lennon lëshon në treg mega hitin e tij "Imagine".

1980 - BRSS dhe Siria nënshkruajnë Traktat të Paqes.



Sipas një kërkimi mbi avantazhet e gjumit vetëm apo në çift, të kryer nga Wendy M. Troxel, docente psikiatre dhe psikologe në Universitetin e Pittsburgut, të flesh me partnerin apo partneren bën shumë mirë për shëndetin, shkruan italiafeed.com. Studimi ka treguar se kur gjumi bëhet në çift, ulet niveli i kortizolit. Po ashtu ulet hormoni i stresit, i cili shkakton depresion dhe ankth si dhe ul nivelin e citokineve, proteina përgjegjëse për inflamacionet. Nga ana tjetër rritet ositoksina, i cili është hormoni i dashurisë, e aftë të shmangë ankthin dhe stresin dhe të ulë presionin e gjakut. Studimi gjithashtu ka demonstruar se gratë, të cilat i zë gjumi pranë partnerit të tyre, arrijnë të flenë shumë më shpejt se gratë apo vajzat single.

### I MORA TË DASHURËN

- Një djalosh tallej me mua duke më quajtur lesbike...

- E ti çfarë bëre?

- Hiç... i mora te dashurën!



BARSOLETA



THËNIA E DITËS



Ka vetëm një problem serioz filozofik, dhe kjo është vetëvrasja!

(Albert Camus)